

VENDIM
Nr. 408, datë 4.7.2018

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONTRIBUTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCave DHE EKONOMISË (MARRËSI), DHE AGJENCISË SUEDEZE PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA), PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTIT
“IMPLEMENTIMI I TAKSËS SË PASURISË TË BAZUAR NË VLERËN E TREGUT,
VERSIONI 0.93,
DATË 20 SHKURT 2018”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për mbështetjen e projektit “Implementimi i taksës së pasurisë të bazuar në vlerën e tregut, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”, nëpërmjet një granti në vlerën prej 36 281 000 SEK (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë) koronash suedeze, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Kontributi i SIDA-s nr. 11217

MARRËVESHJE KONTRIBUTI

NDËRMJET Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), të përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Shqipëri dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“Marrësi”) për mbështetjen e Projektit “Zbatimi i Taksës së Pasurisë mbi Bazën e Vlerës së Tregut”, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018”.

Duke pasur parasysh se:

- marrësi ka kërkuar kontribut financiar nga Suedia për një Projekt të titulluar “Zbatimi i Taksës së Pasurisë mbi Bazën e Vlerës së Tregut” (në vijim i referuar si “Projekti”);
- agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (në vijim e referuar si SIDA) ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur projektin;
- marrësi ka kërkuar të zbatojë Projektin në bashkëpunim me Agjencinë Suedeze të Taksave (në vijim i referuar si “Autoriteti Suedezi”);
- një marrëveshje Projekti nënshkruhet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetit Suedezi, bazuar në dokumentin e projektit (bashkëlidhur si shtojca 1).

SIDA dhe Marrësi kanë rënë dakord si më poshtë:

§ 1. Programi/Projekti

Marrësi dhe SIDA bien dakord që Projekti do të realizohet në përputhje me dokumentin e Projektit (shtojca 1), i titulluar “Zbatimi i Taksës së Pasurisë mbi Bazën e Vlerës së Tregut”, versioni 0.93, datë 20 shkurt 2018.

Qëllimi i Projektit është që të kontribuojë në forcimin e bashkive në Shqipëri, duke rritur ndjeshëm burimin

e të ardhurave të tyre vetjake, duke zbatuar taksën mbi pronën e paluajtshme mbi bazën e vlerës së tregut në ndërtesa, p.sh. njësitë e objekteve.

Tre objektivat specifike të Projektit janë: i) rritja e të ardhurave nga tatimi në pronë; ii) sistemi i tatimit në pronë bazuar në vlerën e tregut; dhe iii) një ekonomi më funksionale.

§ 2. Kontributi suedez

A. SIDA do të vendosë në dispozicion një shumë maksimale të përgjithshme prej tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e tetëdhjetë e një mijë SEK (36 281 000 SEK), në formën e një kontributi grant, për zbatimin e Projektit.

B. Shumat tavan për pagesa nga SIDA do të kufizohen si vijon:

	SEK
Tarifat	11 899 000 SEK
Të rimbursueshme	1 927 000 SEK
Kosto të tjera	22 155 000 SEK
<u>Shuma rezervë</u>	<u>300 000 SEK</u>
Totali	36 281 000 SEK

Buxheti i specifikuar është bashkëlidhur si pjesë e dokumentit të Projektit/shtojca 1.

Kushtet për financimin e SIDA-s janë të specifikuar në dispozitën e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunim me autoritetet, shtojca 2, e cila do të zbatohet për këtë Marrëveshje Kontributi.

§ 3. Kushtet për kontributin suedez

A. Vetëm kostot për aktivitetet e kryera gjatë periudhës që planifikohet të fillojë nga data 15 mars 2018 dhe që do të finalizohet deri më 31 dhjetor 2020, mund të financohen nga kontributi suedez.

B. Nëse nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje ose nëse kushtet për zbatimin e Projektit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, ose qëllimi i Projektit për çfarëdo arsye tjetër nuk pritet të arrihet, SIDA do të ketë të drejtë, në diskrecionin e saj të vetëm, të tërheqë, në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, angazhimin e vet financiar.

C. SIDA dhe Marrësi bien dakord që të bashkëpunojnë për parandalimin e korrupsionit në të gjitha aspektet dhe format gjatë bashkëpunimit dhe zbatimit të Projektit. Marrësi dhe SIDA ndërmarrin më tej marrjen e masave të shpejta dhe përkatëse ligjore dhe të masave të tjera, me qëllim ndalimin, hetimin dhe tarifimin e çdo personi, subjekti ose tjetër, të dyshuar për korrupsion ose keqpërdorime të tjera me paramendim të burimeve.

§ 4. Kontributi i Marrësit

A. Marrësi do të financojë të gjitha kostot e tjera që nuk mbulohen nga kontributi suedez sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të nevojshme për zbatimin e Projektit, siç janë shërbimet dhe pajisjet në natyrë dhe kostot e tjera lokale të përcaktuara më tej në buxhet.

B. Marrësi do të krijojë, gjithashtu, Njësinë për Zbatimin e Projektit, me burime e duhura dhe personel të kualifikuar, të vendosur në ambientet e Marrësit, me qëllim kontraktimin e personelit që i shërben Projektit në kushtet e përzgjedhjes dhe shpërblimit, siç përcaktohet në dokumentin e Projektit dhe me qëllimin për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve që kërkohen për Projektin.

§ 5. Faturimi dhe pagesa nga SIDA

A. SIDA do të kryejë pagesat për shpenzimet e kryera direkt tek Autoriteti Suedez, siç paraqitet në Marrëveshjen midis agjencive për blerjen e shërbimeve dhe në dispozitat e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunimin me autoritetet.

B. Përveç kur është rënë dakord ndryshe, faturat do të miratohen nga Marrësi përpara dërgimit të tyre te SIDA. Asnjë pagesë për Autoritetin Suedez nuk do të kryhet paraprakisht.

C. Data përfundimtare për faturimin te SIDA është data e skadimit të kësaj Marrëveshjeje. SIDA nuk do të paguajë faturat e dorëzuara pas kësaj date.

§ 6. Raportimi

A. Marrësi do të japë informacionin përkatës dhe në kohë tek Autoriteti Suedez, me qëllim që t'i mundësojë Autoritetit Suedez që të përmbushë kërkesat e raportimit, siç përshkruhet në Dispozitat e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunimin me autoritetet.

B. Pavarësisht nga rregullat e pranura të raportimit, Marrësi dhe SIDA do të informojnë menjëherë njëri-tjetrin nëse bëhet e pamundur që të arrihen objektivat e Projektit ose nëse ndodh ndonjë rast tjetër që mund të ndikojë negativisht në zbatimin e Projektit ose nëse qëllimi i punës devijon nga planet dhe afatet kohore të rena dakord.

§ 7. Auditimi dhe monitorimi

Autoriteti Suedez do të kryejë auditime të fondeve suedeze siç përcaktohet në dispozitat e përgjithshme të SIDA-s për bashkëpunimin me autoritetet

Marrësi do të asistojë dhe bashkëpunojë me Autoritetin Suedez dhe SIDA-n, duke monitoruar progresin dhe performancën e Projektit dhe do të ndihmojë në vlerësimet e pavarura.

§ 8. Të drejtat e autorit dhe informacioni

Marrësi dhe SIDA mund të përdorin lirisht dokumentacionin e përgatitur brenda Programit/ Projektit dhe të paguar nga SIDA.

§ 9. Ligji në fuqi dhe mosmarrëveshjet

Kjo Marrëveshje do të zbatohet sipas ligjit material të Suedisë dhe mosmarrëveshjet do të zgjidhen nëpërmjet bisedimeve midis palëve.

§ 10. Hyrja në fuqi dhe përfundimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pasi të jetë nënshkruar nga të dyja palët dhe sapo Ministria e Financave dhe Ekonomisë ta njoftojë SIDA-n me shkrim se procedurat e brendshme të bazuara në legjislacionin shqiptar, të cilat janë të nevojshme që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi, janë plotësuar dhe do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2021, përveç nëse përfundon më herët me njoftim me shkrim tre muaj para nga Marrësi ose SIDA.

Çdo zgjatje e periudhës së vlefshmërisë së kësaj Marrëveshjeje do të kryhet nëpërmjet Marrëveshjes me shkrim midis palëve dhe çdo zgjatje e periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së Projektit ose dokumentit të ngjashëm të financuar nga kjo Marrëveshje, do të kërkojë miratimin paraprak me shkrim nga SIDA.

Janë hartuar dy origjinale teksti të kësaj Marrëveshjeje, nga të cilat secila Palë ka marrë një kopje dhe një kopje e saj do t'i jepet edhe Autoritetit Suedez.

Vendi dhe data
Për Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA)

Vendi dhe data
Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Nënshkrimi
Birgitta Jansson,
Këshilltare, përgjegjëse e Sektorit për
Zhvillim dhe Bashkëpunim në
Ambasadën Suedeze në Shqipëri

Nënshkrimi
Arben Ahmetaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Emri dhe titulli me shkronja të mëdha

Emri dhe titulli me shkronja të mëdha

Shtojcat:

Shtojca 1. Dokumenti i Projektit, duke përfshirë analizën e buxhetit

Shtojca 2. Dispozita e përgjithshme e SIDA-s për Bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve

**Bashki të Fuqizuara
në Shqipëri**

**Rritja e të ardhurave
nga Taksat e Pronës**

**Taksa e Pronës
e bazuar në Vlerën e Tregut**

**Një funksionim
më i mirë i ekonomisë**

**Përmirësimi i
Rregulloreve për
Taksën e Pronës**

**Tatimpagues të
Mirë-përgatitur**

**Regjistrat e
Plotë për
Taksën e
Pronës**

**Zbatimi i
Sistemit të
Centralizuar
të TI-së**

**Zbatimi i
Proceseve të
Biznesit**

ProTax Albania | Projekt Plan

Projekt për Zbatimin

**e Taksimit të Pronës në Bazë të Vlerës së Tregut në
Shqipëri**

Versioni 0.93

Informacioni i Dokumentit

Autori

Ulf Mathiasson, Agjencia Tatimore e Suedisë

Historiku i Rishikimeve

Data	Versioni	Komenti	Nënshkrimi
141212	0.1	Drafti i parë	UM
150322	0.4	Drafti i katërt, i dërguar në MF për diskutim	UM
170427	0.5	Rishikuar nga MF	MoF
170625	0.6	Rishikuar pas misionit të gjetjes së fakteve -maj 2017	UM
171027	0.7	Rishikuar pas misionit të gjetjes së fakteve- shtator 2017	UM
171201	0.8	Përditësuar pas rishikimit nga MFE	AL
171206	0.9	MFE-ja ka shtuar kapitullin 4.2 për PIU-n	UM
180112	0.91	Ka përfunduar Kapitulli 6 për riskun	UM
180207	0.92	Është përditësuar pas rekomandimeve nga TQAC-ja	UM
180220	0.93	Është korrigjuar gabimi i rumbullakosjes në kapitullin 7, Buxheti	UM

Referencat

Matrica e Kuadrit Logjik ProTax Albania	v 1.2
Buxheti dhe Personeli i ProTax Albania	v 1.2
Kriteret Afatshkurtra të ProTax Albania	v 1.0
Organizimi i ProTax Albania	v 1.1
Matrica e Riskut të ProTax Albania	v 1.0

Konceptet dhe shkurtime

ACRP/AT P	Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (ndryshuar në Agjencia e Trajtimit të Pronave)
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
CAMA	Vlerësim masiv me kompjuter
CORINE	Koordinimi i Informacionit për Mjedisin i iniciuar nga BE-ja
EFF	Facilitet i Zgjeruar Fondesh
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
FMN	Fondi Monetar i Zhvillimit
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave
ZRPP	Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme
Lantmäteriet	Autoriteti për Vendosjen në Hartë, Regjistrimin e Tokës dhe Kadastra
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MoF	Ministria e Financave (ishte në vjeshtë 2017, u riorganizua dhe u emërtua MFE)
MIA	Ministria e Punëve të Brendshme
NAIS	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
RRKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
NHA	Agjencia Kombëtare e Banesave
AKPT	Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Pronë	Koncepti “pronë” ndonjëherë përdoret si sinonim me banesën, p.sh. njësi e objektit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
TAIS	Sistemi Informativ për Administratën Tatimore

1. Pse | Qëllimi dhe synimet

1.1 Historiku

Qeveria shqiptare ka vendosur të modernizojë dhe të forcojë sistemin shqiptar të taksimit të pronës. Reforma ka filluar si pjesë e një rregullimi më të gjerë fiskal dhe programit të reformës strukturore, të iniciuar si pjesë e një programi trevjeçar (2014–2016) të FMN-së dhe është konsideruar si një nga fushat kryesore për përmirësimin e performancës. Ai përfshin zbatimin e një sistemi modern për taksimin e pasurisë së paluajtshme, duke u bazuar në vlerën e tregut.

Një objektiv kryesor i reformës ishte rritja e rendimentit aktual shumë të ulët të taksimit të pronës. Një tjetër element kryesor është procesi i reformës strukturore afatmesme që ka transformuar në mënyrë themelore sistemin e financave ndërqeveritare, duke konsoliduar qeveritë lokale në njësi më të mëdha dhe financiarisht të qëndrueshme, me taksimin e pronës që do të dalë potencialisht si një burim më i fuqishëm i financave lokale.

Gjatë vitit 2014, Ministria e Financave (MF) në Shqipëri kreu një vizitë studimore në Kosovë për të vëzhguar sistemin e tyre të taksimit të pronës dhe Projektin e sapofilluar, ProTax2, i cili përfshin taksimin e ndërtesave dhe tokës. Sistemi i Taksimit të Pronës në Kosovë është zhvilluar në bashkëpunim me Agjencinë Tatimore Suedeze dhe si rrjedhojë, Ministria e Financave organizoi një takim me Departamentin e Taksave të Pronës së Kosovës, Agjencinë Suedeze të Taksave dhe Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Në vitin 2016, Ministria Shqiptare e Financave dhe Ministria e Financave të Kosovës nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi në lidhje me ndihmën që do të sigurohet nga qeveria e Kosovës për Kadastrën Fiskale. Më konkretisht, autoritetet kosovare kanë rënë dakord të ndihmojnë Ministrinë Shqiptare të Financave me zbatimin e Sistemit të Kadastrës Fiskale (në formatin e programit kompjuterik), trajnimin e stafit, si dhe ndarjen e përvojës që ata kanë pasur gjatë përdorimit të sistemit.

Në fillim të vitit 2017, Ministria e Financave e Shqipërisë i kërkoi SIDA-s që të shqyrtojë mundësitë e ndihmës në reformimin e sistemit të taksave mbi pronën. Si pjesë e kësaj, SIDA i kërkoi Agjencisë Suedeze të Taksave të kryejë një mision të ri për gjetjen e fakteve në maj të vitit 2017. Pas këtij misioni, Ministria e Financave kërkoi një version të propozimit të Projektit nga viti 2015 për t’u përditësuar me gjetjet nga misioni i fundit.

Ky dokument është rezultat i asaj kërkese.

1.2 Qëllimi i Projektit

Bashki të fuqizuara në Shqipëri

Qëllimi i Projektit është të kontribuojë në forcimin e bashkive në Shqipëri, duke rritur ndjeshëm të ardhurat e tyre vetjake, duke zbatuar taksimin e pronës së paluajtshme *bazuar në vlerën e tregut* për ndërtesat, pra njësitë e objekteve.

1.3 Synimet e zhvillimit | Rezultati

Rritja e të ardhurave nga taksat e pronës	Taksa e pronës bazuar në vlerën e tregut	Një funksionim më i mirë i ekonomisë
---	--	--------------------------------------

Projekti ka tri qëllime kryesore zhvillimi që duhet të arrihen në planin afatgjatë, pas mbylljes së Projektit. Megjithatë, pjesë të tyre do të realizohen tashmë gjatë periudhës së Projektit. Secili prej qëllimeve zhvillimore përshkruhet në kapitujt e mëposhtëm. Për detaje për këto qëllime, shihni bashkëlidhur Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

1.3.1 Rritja e të ardhurave nga taksimi i pronës

Aktualisht, të ardhurat nga taksimi i pronës në Shqipëri janë shumë të ulëta. Sipas disa burimeve nuk janë më shumë se 0.32% e PBB-së në vitin 2016. FMN-ja rekomandon që të ardhurat nga taksimi i pronës të jenë të paktën 0.70% të PBB-së në të ardhmen. Një qëllim afatgjatë mund të jetë rritja e të ardhurave deri në 1% të PBB-së; një për qind për bashkinë.

Një ambicie realiste si rezultat i Projektit të përshkruar në këtë dokument mund të jetë arritja nga 0.5% në 0.8% e PBB-së ose më shumë se 50 milionë euro.

1.3.2 Sistemi i taksimit të pronës në bazë të vlerës së tregut

Sistemi i ri i taksimit të pronës i bazuar mbi vlerën e tregut do të jetë i drejtë, efikas, efektiv dhe transparent.

I drejtë

Sistemi i taksimit të pronës do të jetë i drejtë:

- Vlera e tregut e ndërtesave (njësive të objekteve) si bazë për taksim në vend të një tarife të bazuar në zonë;

- taksimi, gjithashtu, mbi ndërtesat pa leje;
- të paktën 90% e të gjitha ndërtesave (njësive të objekteve) të regjistruara për taksim;
- taksimi i zbatuar në të gjitha bashkitë;
- shkalla e lartë e akumulimit (të paktën 80%).
- Garantohet siguria juridike që do të thotë:
 - krijimi i një baze ligjore të qartë, të saktë dhe të parashikueshme
 - shmangia e ushtrimit të dispozitave me efekt prapaveprues
 - krijimi i rregullave dhe procedurave të hollësishme, për të siguruar qartësi dhe udhëzime mbi elementet themelore të taksimit të pronës;
- njësia qendrore ka të drejtë të nxjerrë vendime detyruese unifikuese për të siguruar trajtim të barabartë në të gjitha bashkitë;
- aktet normative, vendimet ose informacione të tjera të nevojshme zyrtare vihen në dispozicion të publikut dhe çka është më e rëndësishmja, të tatimpaguesit.

Efikas

Sistemi i taksimit të pronës do të jetë efikas:

- shërbimet elektronike të publikuara për të gjitha llojet e nevojave të tatimpaguesve të pasurisë;
- procesi i vlerësimit është i centralizuar;
- procesi i taksimit është i centralizuar dhe i automatizuar;
- harmonizimi i pagesave është i automatizuar;
- vendosja e sistemit të centralizuar të TI-së (TI - Teknologjisë së Informacionit).

Efektiv

Sistemi i taksimit të pronës do të jetë efikas:

- të paktën 90% e të gjitha njësive të objekteve të regjistruara në sistemin e taksimit të pronës;
- do të akumulohet të paktën 80% e taksës së vlerësuar të pronës.

Transparent

Projekti do të punojë gjerësisht me informacionin për tatimpaguesit (shihni kapitullin 2.2) për t'i fuqizuar ata për të marrë pjesë në reformën e taksimit të pronës. Reforma synon transparencën më të madhe të mundshme:

- të gjitha ngjarjet në sistemin TI të taksimit të pronës të ruajtura dhe lehtësisht të aksesueshme për auditim;
- baza për vlerësim (hartat e vlerave të zonës, përshkrimet, nivelet e vlerës, çmimet e shitjes, modeli i vlerësimit) të aksesueshme publikisht në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;
- të ardhurat dhe shpenzimet bashkiake të aksesueshme për publikun në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;
- regjistri i çmimi të shitjes i aksesueshëm publikisht në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;
- vlerat e vlerësuar të aksesueshme publikisht në internet dhe në zyrat vendore të taksimit të pronës;
- borxhet e taksimit të pronës të aksesueshme publikisht (ose të paktën për bankat).

1.3.3 Një ekonomi që funksionon më mirë

Një ekonomi më funksionale është një ndikim më i tërthortë, por sërish shumë i rëndësishëm i Projektit të planifikuar. Ekzistojnë të paktën tri mënyra që pritet të ndikojnë në ekonominë e Shqipërisë.

Një mjedis i përmirësuar i biznesit

Një taksë e qartë e pronës është një mënyrë e parashikueshme, transparente dhe e qëndrueshme për bashkitë për të mbledhur fonde dhe në këtë mënyrë, një kusht për një mjedis të mirë biznesi.

Një treg pronash që funksionon më mirë

Një vlerë zyrtare e taksueshme për ndërtesat (njësitë e objekteve) do të kontribuojë për një treg më transparent të pasurive të paluajtshme. Një treg më transparent do ta bëjë më të lehtë për investitorët që të marrin pjesë në të. Gjithashtu, do të jetë më e lehtë të ndiqni ndryshimet në çmimet e pronës. Këto ndryshime janë një bazë e rëndësishme për vendimet ekonomike dhe politike. Shumë nga këto vendime janë të lidhura me një treg kreditimi që funksionon mirë.

Një treg kredish që funksionon më mirë

Një vlerë e vlerësuar e pronës, e konfirmuar nga shteti, mund të përdoret si bazë për marketingun e kredive dhe do të zvogëlojë nevojën për një vlerësim të vetëm të pronave. Mund të jetë, gjithashtu, baza për marketing kreditimi nëse sistemet TI përdoren nga aktorët në tregun e pasurive të paluajtshme për proceset e brendshme

efikase në gjykimin e vlerave. Në afat të gjatë kjo do të çojë në interesa më të ulëta për marketingun e kreditimit të pronave në tregun e pasurive të paluajtshme.

1.3.4 Perspektiva gjinore

Arritjet në kuadrin rregullator gjatë viteve të fundit kanë përcaktuar garanci të fuqishme për të drejtën e grave për të zotëruar pronë. Megjithatë, ato kanë qenë të pamjaftueshme për të sjellë ndryshimin e dëshiruar për përmirësimin e barazisë gjinore.

Pavarësisht faktit se gratë në Shqipëri përbëjnë përafërsisht gjysmën e popullsisë, shumica e pronave janë të regjistruara në emër të burrave. Dy pengesa kryesore, ndër të tjera, kanë kontribuar për këtë. Informaliteti në sektorin e pronës dhe pengesat kulturore që rrjedhin nga ligji zakonor i vjetër.

Informaliteti është dominues duke pasur parasysh numrin e madh të ndërtesave pa leje që nuk legalizohen dhe pronat e tjera që nuk janë të regjistruara në ZRPP. Ritmi i ngadaltë i procesit të formalizimit i ka penguar gratë të regjistrohen dhe të ushtrojnë plotësisht të drejtën e tyre për pronë.

Gjithashtu, ato herë pas here përballen me vështirësi për të trashëguar pronën nga prindërit ose bashkëshorti, si dhe për të regjistruar pasurinë në emër të tyre, për shkak të presionit social, traditës dhe normave kulturore. Për shkak të këtyre faktorëve, ato heqin dorë nga të drejtat e trashëgimisë së tyre në favor të anëtarëve meshkuj të familjes ose ngurrojnë të regjistrojnë pronën në emër të tyre.

Projekti do të kontribuojë në përshpejtimin e procesit të formalizimit të të drejtave të pronës në Shqipëri dhe do të ndihmojë në përfundimin e tij në kohë të arsyeshme, duke ofruar informacione të konsiderueshme e të dobishme për pronën tek ALUIZNI dhe ZRPP-ja.

Përveç kësaj, një vlerë transparente e pronës, e konfirmuar nga shteti, do të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe vendosmërisë midis vetë grave për të kërkuar trashëgiminë dhe të drejtat e tyre për pronë. Kjo, nga ana tjetër, do të forcojë statusin ligjor të grave dhe do të shërbejë si hap thelbësor drejt përmirësimit të barazisë gjinore.

Regjistrat e tatimit të pronës, gjithashtu, do të sigurojnë një numër të madh statistikash që do të inkurajojnë dhe ndihmojnë studiuesit dhe akademikët që merren me çështje gjinore, për të kryer studime/analiza më të hollësishme dhe të përshtatshme për këtë çështje. Për shembull, një regjistër tatimor me vlera të pronës mund të tregojë “pasuri” të grave dhe në këtë mënyrë të veprojë si një tregues mbi mënyrën sesi gratë menaxhojnë pronën në krahasim me burrat.

Duke paraqitur vlerat e pronës në një regjistër tatimor dhe duke bërë publike vlerat e pronës, më shumë gra do të jenë të vetëdijshme për rëndësinë e menaxhimit të pronës si një mënyrë për të fuqizuar veten. Gratë nuk janë gjithmonë të vetëdijshme për faktin se pronësia e pronës dhe përdorimi efektiv i pronës mund të jenë një mënyrë për rritjen ekonomike, si për vete ashtu edhe për shoqërinë. Përcaktimet e një regjistri tatimor publik për pronat dhe vlerat e pronave do të lehtësojnë njohuritë për këtë çështje. Në kombinim me PR strategjike nga autoritetet në mënyrën se si pronat dhe vlerat e pronës mund të jenë bazë për investime dhe të sigurta për shënimin e kreditimeve (veçanërisht nëse tregu i kreditimeve mund të paraqesë edhe më shumë hua koncesionare për mundësitë e biznesit të grave) do të rrisë aftësitë e grave për të ushtruar të drejtat e tyre të pronësisë në praktikë.

Rishpërndarja e pasurisë në favor të grave

Shumica e pronave në Shqipëri janë, siç u përmend më lart, në pronësi të burrave. Kjo do të thotë se edhe një pjesë e madhe e detyrimeve tatimore të pronës do të bien mbi ta. Konsumi i shërbimeve bashkiake publike të financuara nga taksat, nga ana tjetër, mund të supozohet se është i shpërndarë në mënyrë më të barabartë. Kjo do të thotë që pasuria e shpërndarë në mënyrë të pabarabartë do të rialokohet në një mënyrë më të barabartë ndërmjet gjinive.

1.3.5 Kontributi në agjendën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE

Zbatimi i nismave të reformës së Projektit pritet të japë rezultate që do të ndikojnë në dy nga pesë prioritetet kryesore në agjendën e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Përkatesisht, prioriteti kryesor nr. 3, “Lufta kundër korrupsionit dhe përforsimi i të drejtave të pronësisë si pjesë integrale e përparësisë kryesore”; nr. 5, “Të drejtat themelore”.

Mekanizmat në kuadrin ligjor të ndryshuar mbi taksën e pronës do të ndihmojnë qeverinë të intensifikojë përpjekjet e saj kundër korrupsionit në këtë fushë. Gjithashtu, në sistemin e ri të centralizuar të IT-së do të jetë e vështirë të ndërhyhet me të dhëna, pasi të gjitha ngjarjet do të ruhen dhe do të aksesohen lehtësisht për auditimin, duke parandaluar në këtë mënyrë korrupsionin.

Gjithashtu, Projekti do të lehtësojë dhe përshpejtojë, nëpërmjet informacioneve të siguruar nga regjistrat e taksimit të pronës (kadastra fiskale), identifikimin e pronës, legalizimin dhe procesin e regjistrimit, të kryer nga ALUIZNI dhe IPRO. Të drejtat e formalizuara dhe të regjistruara të pronësisë në regjistrat e ZRPP-së mund të ushtrohen plotësisht dhe vazhdimisht të zbatohen nga agjencitë qeveritare dhe gjykatat, duke

garantuar siguri më të madhe juridike për pronarët e pronave në Shqipëri.

Kjo do të reduktojë informalitetin e përhapur në sektorin e pronave të paluajtshme dhe do të forcojë të drejtat e pronësisë, si dhe do të kontribuojë në krijimin e një sistemi formal të pronave si parakusht për një ekonomi të tregut të fortë.

Krijimi i kadastrës fiskale dhe modernizimi i taksës së pronës është një masë reforme “qëllimi strukturor” që është mjaft e rëndësishme për të arritur qëllimet në kuadrin e rregullimit fiskal dhe programit të reformave të mbështetura nga FMN-ja. Kjo do të përmirësojë rrugën e vendit drejt reformës strukturore duke rritur performancën makro-fiskale dhe efikasitetin e përgjithshëm ekonomik në shpërndarjen e burimeve. Komisioni Evropian përkrah afate të tilla si nxitja e rritjes dhe prosperitetit në Shqipëri.

Projekti do të jetë një kontribues kryesor në procesin e decentralizimit fiskal duke rritur të ardhurat tatimore të burimeve të veta dhe përgjegjësinë fiskale në nivel lokal, duke qenë në përputhje me parimet e BE-së. Së fundi, përmirësime të ndryshme në sistemin e taksimit të IT-së do të rrisin efikasitetin dhe transparencën dhe do të parandalojnë korrupsionin.

1.3.6 Të drejtat e njeriut dhe perspektiva e varfërisë

Imponimi dhe mbledhja e taksave të pronës është një kufizim legjitim i të drejtave të pronës. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, vendet anëtare gëzojnë një kufi të gjerë vlerësimi gjatë vendosjes së politikës së tyre tatimore.

Megjithatë, shtetet nuk lejohen të vendosin asnjë lloj regjimi tatimor. Duhet të krijohet një ekuilibër i duhur midis nevojës për të gjeneruar të ardhura tatimore dhe objektiva të tjerë të politikës publike, siç është nevoja për të shmangur implikimet e pafavorshme tatimore për komunitetet në vulnerabël.

Si rrjedhojë, qasja më e mirë do të ishte një regjim tatimor që përmban masa mbrojtëse që adresojnë çështje sociale dhe që nuk krijojnë kërkesa të tepruara për personat e varfër dhe me të ardhura të ulëta.

Për të arritur këtë dhe përveç përjashtimeve për grupet vulnerabël¹ të parashikuara në sistemin aktual, Projekti do të mbrojë fuqishëm përfshirjen në kuadrin e ri të taksimit të pronës të një zbritjeje të përgjithshme (që përbëhet nga një shumë fikse parash) nga vlera e vlerësuar e ndërtesës që shërben si vendbanim kryesor dhe një mundësi efektive për të shtyrë pagesat e taksimit të pronës për grupet e varfra. Për më tepër, meqë nuk është e këshillueshme rritja e papritur e barrës së taksës së pronës, në fillim, taksa e pronës pritet të vendoset me ritme të ulëta.

Duke përdorur këtë qasje, fenomeni i *Gentrification* (Rinovimit) minimizohet, gjithashtu. Për shkak të këtij fenomeni, në disa raste, vlerat e përmirësuar të pronës dhe si rezultat taksat më të larta të pronës detyrojnë pronarët të shesin pronat e tyre ku banojnë në zona të shtrenjta dhe vendosen në zona të tjera me vlera më të ulëta të pronës.

Është, gjithashtu, e rëndësishme të theksohet se në përputhje me aktivitetet e përshkruara në kapitullin 2.2 të këtij dokumenti, Projekti planifikon të kryejë konsultime të gjera dhe të krijojë një platformë të përherëshme komunikimi/dialogu me tatimpaguesit, ku ata mund të shprehin shqetësimet e tyre dhe të informohen në mënyrë të përshtatshme për të drejtat/detyrimet dhe përfitimet e tyre nga taksa e pronës.

Në këtë kuadër, përdorimi i teknologjisë digjitale dhe e-shërbimeve do të rrisë ofrimin e shërbimeve të gjithë shqiptarët, duke përfshirë ata që jetojnë jashtë vendit, si dhe grupet e marginalizuara dhe vulnerabël që nuk gëzojnë akses të lehtë në institucionet qeveritare. Natyrisht, do të jetë e mundur, gjithashtu, të merren të gjitha shërbimet në zyrat bashkiake për ata që nuk mund ose nuk duan të përdorin opsionet digjitale.

Ndikimi i reformës së planifikuar për rritjen ekonomike që tejkalon qëllimin kryesor të rritjes së të ardhurave nga taksa e pronës përshkruhet në kapitullin 1.1.3 të këtij propozimi të Projektit. Reforma pritet të nxisë zhvillimin ekonomik, duke nxitur përdorimin më efikas të pronave dhe duke promovuar një treg prone transparent dhe aktiv, i cili do të nxisë transaksionet e tregut.

Megjithatë, siç u përmend më lart, qëllimi përfundimtar i Projektit është forcimi i bashkive të reja në Shqipëri duke rritur mjetet për financimin e investimeve kapitale në infrastrukturën bashkiake dhe shërbimet lokale që rrisin vlerën e tregut të pronave të paluajtshme dhe rrisin shërbimet publike. Kjo luan rol të rëndësishëm në rishpërndarjen e pasurisë në favor të personave me mjete të kufizuara dhe përmirëson jetën shoqërore të të gjithë qytetarëve, duke përfshirë segmentet e marginalizuara dhe vulnerabil të popullsisë.

Projektet e reja publike (parqet, shkollat, kopshtet, terrenet sportive, objektet rekreative etj.) të financuara nga të ardhurat nga taksa e pronës do të përmirësojnë jetën e përditshme shoqërore të anëtarëve të komunitetit duke kontribuar në këtë mënyrë në krijimin e kapitalit social përmes komunikimit dhe ndërveprimeve.

¹ Ligji i ndryshuar kohët e fundit për sistemin e taksave vendore kërkon, ndër të tjera, përjashtimin e: a) Pensionistëve pa asnjë mbështetje nga anëtarët e tjerë të familjes; b) familjet e mbështetura nga ndihma sociale; c) Personat që përfitojnë strehim social; dhe d.) Qiramarrësit e ndërtesave të banimit që përdorin këto prona duke paguar qiranë jo të liberalizuar.

1.3.7 Ndikimi në mjedis

Mënyra sesi komunat do të zgjedhin të shpenzojnë të ardhurat e parashikuara të taksës së pronës, natyrisht që është jashtë fushës së Projektit, por mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis. Të ardhurat u japin bashkive mundësi për të investuar më shumë në furnizimin me ujë të sigurt, kanalizime dhe infrastruktura të tjera që mund të përmirësojnë mjedisin.

Projekti planifikon të hartojë të gjitha proceset e reja të biznesit me fokus në shërbimet elektronike, komunikimin me *e-mail* dhe informacionet në internet. Kjo do të bëjë që proceset e jashtme dhe të brendshme të jenë jo vetëm efikase, por edhe që mjedisi të ketë përfitime dhe të zvogëlohet ndikimi negativ në ndryshimet klimatike. Konsumi i letres dhe printimit do të jetë më i ulët. Ashtu siç do të jetë edhe nevoja për transport për dërgimin e faturave dhe njoftimeve. Megjithatë, ndoshta ndikimi më i madh pozitiv i ofritit të shërbimeve elektronike dhe informacioneve *online* është nevoja e reduktuar për tatimpaguesit që të udhëtojnë për të vizituar zyrat e taksës së pronës.

Lidhur me ndikimin e drejtpërdrejtë mjedisor të zbatimit të Projektit, shihni kapitullin [Aspektet mjedisore të zbatimit të Projektit](#). Aspektet mjedisore të zbatimit të Projektit.

2. Çfarë | Rezultatet e Projektit



Projekti do të japë pesë rezultate kryesore të Projektit. Secili prej tyre përshkruhet në kapitujt më poshtë. Për më shumë detaje për rezultatet e Projektit, shihni Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

2.1 Rregullore të përmirësuara për taksimin e pronës

Zbatimi i reformës së taksës së pronës kërkon ndryshime të rëndësishme në të gjithë infrastrukturën ligjore që rregullon proceset e taksës së pronës. Një bazë rregullatore e drejtë, e parashikueshme dhe e qartë, e cila është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Shqipëri, rregulloret e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, është vendimtare për pranimin nga tatimpaguesit. Legjislacioni i ri duhet të garantojë një administrim të drejtë, efikas, efektiv dhe transparent të taksës së pronës dhe duhet të sigurojë qartësi të mjaftueshme dhe udhëzime për komponentët kryesorë të miratuar dhe risitë e reformës. Në këtë kuadër, Projekti synon të kryejë një vlerësim gjithëpërfshirës të legjislacionit aktual të taksës së pronës, i cili do të vijohet nga hartimi i akteve të reja ligjore dhe nënligjore. Këto draftakte ligjore do të dorëzohen te MFE-ja për përpunim të mëtejshëm në qeveri gjatë vitit 2018. Rregulloret e reja duhet të jenë në fuqi deri në fund të vitit 2019, të cilat do të zbatohen sipas planit të paraqitur në këtë dokument.

Para taksimit të parë, i cili është planifikuar për fazën e Specifikimit 2018, Projekti do të hartojë rregulloret e nevojshme kalimtare. Për shembull, është e nevojshme që të ekzistojë një rregull për zonën e supozuar të njësive të objekteve kur këto të dhëna nuk janë deklaruar nga tatimpaguesi në OSHEE ose janë të njohura nga ndonjë burim tjetër.

2.2 Tatimpagues të mirëpërgatitur

Për të qenë i suksesshëm në zbatimin e taksës së pronës, është shumë e rëndësishme që të ekzistojë pranimi nga tatimpaguesit. Në fushën e shërbimit të tatimpaguesit, Projekti do të fokusohet në tri fusha për të fituar pranimin e tatimpaguesve:

1. Tatimpaguesit duhet të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre;
2. Tatimpaguesit duhet të shohin se marrin diçka nga pagesa e taksës së pronës;
3. Tatimpaguesit duhet të kenë besim në taksën e pronës dhe në autoritetet e taksës së pronës.

Për të përmbushur këtë, Projekti planifikon që të bëjë të disponueshme informacionet përmes një sërë kanalesh të ndryshme ku kanalet më të rëndësishme janë:

- një faqe interneti për taksën e pronës.
- materiale informative, siç janë fletëpalosjet dhe broshurat në dispozicion në bashki dhe vende të tjera ku mund të arrihen pronarët e pronave.
- stafi i mirarsimuar.

Rezultatet e pritshme në këtë fushë janë:

2.2.1 Krijimi i një faqeje interneti për taksën e pronës

Në fillim të Projektit do të ekzistojë një faqe interneti për taksën e pronës. Në këtë faqe interneti tatimpaguesit do të gjejnë të gjitha informacionet që duhet të dinë për taksën e pronës, siç janë informacionet për të drejtat dhe detyrimet e tyre. Ata, gjithashtu, do të gjejnë informacione mbi mënyrën sesi përdoren të ardhurat nga taksa e pronës në mënyrë që të mund të shohin se në të vërtetë marrin diçka nga pagesa e taksës së pronës.

2.2.2 Tatimpaguesit informohen se për ndërtesat zbatohet një taksë prone e bazuar në vlerën e zonës fiskale

Tatimpaguesit njoftohen herët se një taksë prone që bazohet në vlerën e zonës fiskale do të zbatohet në ndërtesa (njësi objektesh). Ata janë të vetëdijshëm mbi mënyrën sesi llogaritet vlera dhe cilat norma taksash do të zbatohen. Ata janë, gjithashtu, të vetëdijshëm për rëndësinë e sigurimit të regjistrimit të informacioneve të sakta për pronën.

2.2.3 Tatimpaguesit informohen se do të zbatohet një taksë pasurie e bazuar në vlerën e pronës

Tatimpaguesit informohen se do të zbatohet një taksë prone e bazuar në vlerën e tregut. Ata janë të vetëdijshëm mbi mënyrën sesi llogaritet vlera dhe cilat norma taksash do të zbatohen.

2.2.4 Tatimpaguesit informohen për vlerën e ndërtesës të tyre dhe për efektet ekonomike të saj

Kur vlerësimi i parë është kryer, tatimpaguesit janë të vetëdijshëm për vlerën pas vlerësimit të ndërtesave të tyre dhe sa taksa duhet të paguajnë për të. Ata janë, gjithashtu, të vetëdijshëm mbi mënyrën sesi dhe kur do të paguajnë taksën e tyre dhe pasojat e mospagesës. Tatimpaguesit janë, gjithashtu, të vetëdijshëm për të drejtat e tyre për ankesë.

2.2.5 Tatimpaguesit informohen se çfarë do të marrin mbrapsht nga pagesa e taksës së pronës

Për të rritur pranimin nga tatimpaguesit, është shumë e rëndësishme t'u tregosh atyre se në fakt marrin diçka nga pagesa e taksimit të pronës. Si rrjedhojë, është shumë e rëndësishme që bashkitë të jenë shumë transparente për mënyrën sesi ata përdorin të ardhurat nga taksa e pronës për të përmirësuar jetën e përditshme për qytetarët.

2.2.6 Tatimpaguesit e dinë se janë të disponueshme shërbimet elektronike

Kur të prezantohen shërbimet elektronike, tatimpaguesit do të jenë të vetëdijshëm mbi mënyrën sesi mund të përdoren ato.

2.3 Regjistra gjithëpërfshirës të taksës së pronës

Parakusht për një sistem të taksave të pronës të bazuar në vlerën e tregut që funksionim mirë është një regjistër gjithëpërfshirës me cilësi të mirë. Një nga përpjekjet më të mëdha të Projektit do të jetë krijimi/mbledhja e informacionit nga shumë prej tyre dhe përdorimi i këtij informacioni për Kadastrën Fiskale.

Përpjekja do të ndahet në dy faza:

- faza e parë do të konsistojë në përdorimin e të dhënave të vetëdeklarimit të pronës nga një regjistrim i gjerë i kryer nga OSHEE-ja si bazë për vlerësimin e taksave;
- faza e dytë do të konsistojë në integrimin e regjistrave të ndryshëm të pronës në Kadastrën Fiskale.

Informacione më të hollësishme në lidhje me regjistrat e ndryshëm që do të prodhojë Projekti jepen më poshtë.

OSHEE	Të dhënat për të gjitha njësitë e banimit me elektricitet	Zhvendosja e të dhënave për njësi objekti & Shkëmbimi i të dhënave të faturimit dhe pagesës	Njësi banese të regjistruara
	Të dhënat e pagesës		Pagesa e regjistruar
ZRPP	Zonat fiskale me nivele të vlerës	Zhvendosja e niveleve të vlerës & Integrimi për të dhëna të tjera	Zhvendosja e Niveleve të vlerës
	Të dhënat e pronës		Integrimi për të dhënat e pronës online
Bashkitë & Të tjera	Të dhënat e pronës	Shkrirja e të dhënave të pronës nga bashkitë dhe burime të tjera me të dhënat e OSHEE-së	Shkrirja e të dhënave të pronës
ASIG	Kufijtë vektorialë të Bashkive dhe kutitë, ortofotot, etj.	Formati dhe përpunimi i të dhënave gjeohapësinore (Ortofotot, Kufijtë, Gjurmët, etj.)	Të dhënat e përshtatura gjeohapësinore
			Regjistri i Taksave të Pronave
RrKGJC (Regjistri Civil)	Gjurmët e godinave	Integrimi për të dhënat e personit fizik	Integrimi për të dhënat e personit fizik online
QKR (Regjistri i Bizneseve)	Numrat e Bizneseve	Integrimi për të dhënat e personit juridik	Integrimi për të dhënat e personit juridik online
ZRPP	Të dhënat e shitjes së pronës	Integrimi për të dhënat e shitjeve online & Verifikimi dhe klasifikimi i të dhënave të shitjes	Integrimi për të dhënat e shitjeve online
			Të dhënat e shitjes të verifikuara dhe të klasifikuara
			Regjistri i Çmimit të Shitjes së Pronës

Figura 1. Ilustrim i burimeve të ndryshme të jashtme të të dhënave për krijimin e regjistrave të taksës së pronës dhe çfarë përpunimi Projekti planifikon të bëjë me të.

2.3.1 Krijimi i regjistrat qendror të taksës së pronës (Kadastra Fiskale)

- Një Regjistër qendror për taksën e pronës (Kadastra Fiskale) i krijuar në bazë të:
- regjistrat ekzistues të OSHEE-së;
- regjistrat ekzistues të ZRPP-së;
- regjistrimeve të mundshme në bashki dhe burime të tjera, si për shembull, ALUIZNI;
- të dhënave ekzistuese gjeohapësinore në ASIG, në dispozicion;
- regjistrat ekzistues RRGJC;
- regjistrat ekzistues QKB.

2.3.2 Krijimi i hartave me vlerat e zonave

- Hartat e zonave të vlerave të veçanta me nivelet përkatëse të vlerës që mbulojnë në gjithë Shqipërinë, të krijuara për:

- objekte bujqësore;
- objektet rezidenciale;
- objekte tregtare;
- objekte industriale.

2.3.3 Krijimi i regjistrat qendror për çmimet e shitjes së pronave

- një regjistër qendror i çmimeve të shitjes i përbërë nga të gjitha shitjet e disponueshme të pronave që nga viti 2015 të vendosura në Kadastrën Fiskale;
- të gjitha shitjet e disponueshme të pronave që nga viti 2015 janë verifikuar dhe klasifikohen si përfaqësuese ose jo.

2.3.4 Vlerësimi i të gjitha ndërtesave (njësive të objekteve)

- të gjitha njësitë e objekteve vlerësohen në bazë të vlerës së tregut.

2.4 Instalimi i një sistemi të përqendruar TI-je

Një sistem TI i taksës së pronës për admini-strimin e taksës së pronës në një nivel vendi/ qeveritar është hartuar dhe është në përdorim në Kosovë. Është ndërtuar duke përdorur teknologji moderne me komponentë të hapur, korniza dhe platforma në kombinim me logjikën e biznesit të sipas nevojave përkatëse. Sistemi i TI-së funksionon mbi një bazë komponentësh me burim të hapur pa prokurim fillestar ose kosto vjetore të licencës.

Projekti planifikon të zhvillohet në dy faza:

- Faza 1: të zbatohet sistemi i taksës së pronës bazuar në vlerën e zonës fiskale, duke rishfrytëzuar sistemin e TI-së së Kosovës dhe, pas rregullimeve mjaft të rëndësishme, ta zbatojë atë në kontekstin shqiptar duke përdorur të dhënat e vetëdeklaruar nga një regjistrim i gjerë i kryer nga OSHEE-ja si bazë për llogaritjet e taksave.

Për fazën e parë, sistemi do të përdorë të dhënat e regjistrimit, do të llogarisë taksën e pronës dhe do të faturojë tatimpaguesin çdo muaj së bashku me faturën e energjisë elektrike nga OSHEE-ja.

- Faza 2: Integrimi i regjistrave të tjerë në sistem dhe përshtatja e tij me taksën e pronës të bazuar në vlerën e tregut me një ndër funksionet e tjera të CAMA-s (funksionaliteti i sistemit të TI-së ilustruhet më poshtë).

SISTEMI I IT-SË I TAKSAVE TË PRONËS		
Monitorim	Kontrolli UC01	Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)
Regjistruesi	Regjistri UC02	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
Vlerësuesi	Vlerësimi UC 03	ASIG/ZRPP
Zyrtar Taksash	Taksa UC04	Koha
Akumulues/Grumbullues	Grumbullim UC05	OSHEE/Thesari/TAIS
Zyrtar Shërbimi	Shërbim Përdorimi UC06	Tatimpaguesi
Administrator Sistemi	Sistem Administrimi UC07	Faqe Interneti

Figura 2 Përdorimi i modelit që ilustron kërkesat funksionale të sistemit TI të taksës së pronës.

Sistemi i TI-së është planifikuar që të përmbajë funksionalitetin dhe mbështetjen për të gjitha proceset e biznesit nga proceset drejtuese mbi proceset thelbësore deri te shërbimet elektronike për tatimpaguesit.

2.4.1 Mjetet për proceset e drejtimit:

- raporti i vlerësimit;
- raporti i mbledhjes;
- raporti i borxhit;
- raporti i ngjarjes.

2.4.2 Mjetet dhe mbështetja për procesin e regjistrimit:

- mbështetje për regjistrimin e automatizuar të pronave nga ZRPP-ja;
- mjetet për regjistrimin e ndërtesave (pa leje) (njësitë e objekteve);
- mjetet për regjistrimin e tatimpaguesve dhe zotëruesi/poseduesi;
- mjetet për mirëmbajtjen e të dhënave të pronës.

2.4.3 Mjetet dhe mbështetja për procesin e vlerësimit:

- mjetet për menaxhimin e hartave të zonave të vlerës dhe nivelet e vlerave;
- mjetet për vlerësimin e testimeve;
- mbështetje për vlerësimin masiv (CAMA) bazuar në metodën e krahasimit të shitjeve;
- mjetet për vlerësim të vetëm;
- mbështetje për njoftimet e vendimeve të vlerësimit;
- mjetet për të klasifikuar dhe verifikuar të dhënat e çmimeve të shitjes;
- mjetet për të klasifikuar të dhënat e tregut të pronës;
- mjetet për të verifikuar të dhënat e tregut të pronës;
- mjetet për analizën e tregut të pronës.

2.4.4 Mjetet dhe mbështetja për procesin taksimi dhe grumbullimi:

- mjetet për menaxhimin e normave tatimore;
- mjetet për vlerësimin e testit të taksës;
- mbështetje për vlerësimin e taksave masive;
- mjetet për vlerësimin e taksave të vetme;
- mbështetje për të nxjerrë fatura ose të dhëna faturimi në bazë të kërkesave nga secila bashki;
- mbështetje për *pajtimin/koordinimin* e pagesave;
- mjetet për menaxhimin e borxhit (fatura e veçantë e borxhit, njoftimi i mbetur (kujtesë), filtrimi etj.).

2.4.5 Mjetet dhe mbështetja për proceset e shërbimit të taksapaguesve:

- shërbimi elektronik për faturën e taksës së pronës;
- shërbimi elektronik për certifikatën e pagesës;
- shërbimi elektronik për informacionin e pronës;
- shërbimi elektronik për informacion financiar (llogari);
- mbështetje për publikimin e informacionit nga sistemi i TI-së në mënyrë të drejtpërdrejtë në internet (hartat e zonave me vlera, nivelet e vlerave, normat e taksave etj.).

2.4.6 Integrimi

Sistemi i TI-së do të marrë informacion sa më afër burimit të tij që të jetë e mundur dhe, gjithashtu, të shmangë ruajtjen e të dhënave dy herë. Për të arritur këtë, sistemi duhet të integrohet me burimet e mëposhtme:

- ASIG/ZRPP për të dhënat gjeohapësinore, të pronave, të pronësisë dhe shitjeve;
- OSHEE për shkëmbimin e të dhënave të faturimit dhe pagesës;
- TAIS për të dhënat e pagesës;
- thesari për *pajtimin* e pagesave nga viti 2020;
- Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) për të dhënat e tatimpaguesit fizik, të dhënat e adresës së banesës/godinës dhe gjurmët e gishtave;
- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për të dhënat e tatimpaguesit ligjor.

2.4.7 Të tjera që duhen dorëzuar:

- dokumentacioni i kërkesave/kritereve (përdorni modelin e rastit etj.);
- dokumentacioni i programit kompjuterik (SAD).

2.5 Zbatimi i proceseve të biznesit

Ekzistojnë tri procese kryesore në sistemin e taksës së pronës, regjistrohuni, kryeni vlerësimin dhe taksoni dhe mbledhni. Qëllimi kryesor i proceseve kryesore është mbledhja e mjeteve për shërbim më të mirë bashkiak në një mënyrë efikase dhe të drejtë. Taksa mbledhet çdo muaj tatimor. Informacioni i nevojshëm për taksën është një pronë e regjistruar me një vlerë të vlerësuar.




Figura 3 Modeli i Procesit të Biznesit që ilustron proceset e nivelit të lartë të administratës tatimore të pronës

Përveç mbledhjes së të ardhurave nga taksa e pronës, proceset, gjithashtu, prodhojnë mallra të tjera, si për shembull, transparenca në tregun e pronës dhe informacioni për tregun e kreditimit.

Natyrisht, ka edhe procese që drejtojnë dhe mbështesin biznesin, si dhe proceset e shërbimit të tatimpaguesve që janë të disponueshme për të “lubrifikuar” proceset kryesore.

2.5.1 Parandalimi i korrupsionit

Administratat e taksës së pronës mund t’i nënshtrohen lehtësisht korrupsionit. Për këtë arsye, proceset e biznesit duhet të hartohen në mënyrë që të parandalojnë veprimet e korrupsionit, duke i bërë të vështira për t’u kryer dhe të lehta për t’u zbuluar.

- Proceset e auditimit do të mbështeten nga mjete të fuqishme auditimi në sistemin e TI-së së taksës së pronës, të gjitha ngjarjet/rastet do të regjistrohen dhe filtrohen lehtësisht për qëllime të ndryshme auditimi.

- Të gjitha ndryshimet në regjistrim, vlerësim dhe taksim do të gjurmohen në vijim të një vendimi zyrtar.

- Transparenca në procesin e vlerësimit do të garantohet nëpërmjet publikimit të të gjitha shitjeve të pronave të përdorura dhe që nuk merren parasysh gjatë krijimit të zonave me vlerë dhe të niveleve të vlerës, d.m.th., do të jetë e mundur për cilindo që të shohë se ku bazohen vlerat e vendosura.

2.5.2 Proceset drejtuese

Disa procese drejtuese do të hartohen dhe zbatohen nga Projekti në komuna dhe në nivel qendror në Kadastrën Fiskale. Ajo përfshin nënproceset e mëposhtme:

- procesin rregullator;
- ndjekjen;
- auditimin.

2.5.3 Procesi i regjistrimit

Procesi i Regjistrimit do të hartohet nga Projekti dhe do të zbatohet në bashki. Ai përfshin nënprocesin e mëposhtëm:

- regjistrimi i objektit dhe njësisë së objektit;
- regjistrimi i pronësisë/posedueshmërisë.

2.5.4 Procesi i vlerësimit

Procesi i vlerësimit do të hartohet nga Projekti dhe do të zbatohet në nivel qendror, p.sh. Kadastra Fiskale. Ajo përfshin nënproceset e mëposhtme:

- menaxhoni të dhënat e tregut;
- zhvilloni modelin e vlerësimit;
- ruani modelin e vlerësimit;
- kryeni vlerësimin e testimit;
- kryeni vlerësimin masiv;
- shpërndani certifikatën e vlerësimit të vlerësuar.

2.5.5 Procesi i taksimit dhe grumbullimit

Normat e taksave përcaktohen në përputhje me legjislacionin përkatës nga ana e bashkive. Taksimi do të kryhet në nivel qendror nga ana e Kadastrës Fiskale. Ky proces do të hartohet dhe zbatohet nga Projekti.

Kadastra Fiskale prodhon fatura (digjitale) dhe informacione faturimi. Bashkitë printojnë, shpërndajnë ose bashkojnë informacionet e faturimit me faturat e tjera sipas dëshirës. Procesi i faturimit do të hartohet dhe zbatohet nga Projekti në nivel vendor dhe qendror.

Procesi i taksimit dhe grumbullimit përmban nënproceset që vijojnë:

- ruajtjen e normave tatimore;
- kryerjen e taksimit në masë;
- prodhimin dhe shpërndarjen e faturës;
- grumbullimin;
- menaxhimin e borxheve;
- zbatimin.

2.5.6 Proceset e shërbimit të taksapaguesit

Proceset e shërbimeve të tatimpaguesit do të zbatohen për të siguruar shërbim funksional të tatimpaguesve edhe për afate të gjata pas përfundimit të Projektit. Pjesa më e madhe e takimeve me tatimpaguesit natyrisht do të zhvillohen në nivel vendor dhe takimet fizike me tatimpaguesit do të jenë përgjegjësi e administratës tatimore vendore, por për të siguruar që këto takime të jenë të cilësisë së mirë dhe të frytshme për tatimpaguesit, këto procese do të zhvillohen në nivel qendror.

Proceset e shërbimit të tatimpaguesve përfshijnë:

- informimin e tatimpaguesit;
- takimin me tatimpaguesit;
- mirëmbajtjen e faqes së internetit;
- mirëmbajtjen e kanaleve të tjera të informimit.

2.5.7 Proceset mbështetëse

Proceset mbështetëse përfshijnë:

- mbështetjen e procesit të përdoruesve (sporteli);
- funksionimin e sistemit të TI-së (sistemi do të organizohet dhe operohet nga NAIS-ja);
- ruajtjen dhe zhvillimin e sistemit të TI-së (të prokuruar si shërbim).

2.5.8 Personeli i trajnuar

Për të zbatuar proceset në mënyrë të qëndrueshme, Projekti do të kryejë shumë trajnime për funksionet qendrore dhe bashkiake.

Personeli qendror (Kadastra Fiskale):

- një ose dy punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar për arkitekturën dhe zhvillimin e biznesit;
- një ose dy punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar në juridiksionin e taksës së pronës;
- dy deri në tre punonjës (dhe vlerësues privatë) janë të trajnuar dhe të autorizuar në metodologjinë e vlerësimit dhe vlerësimin masiv;
- dy deri në tre punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar në procedurat e taksimit, mbledhjes/grumbullimit dhe zbatimit;
- dy deri në tre punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar mbi mënyrën sesi të përdorin GIS;
- dy deri në tre punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar për komunikimin dhe informimin e Tatimpaguesit;
- një ose dy punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar për analizat e sistemeve dhe menaxhimin e kërkesave të TI-së;
- një ose dy punonjës janë të trajnuar dhe të autorizuar në metodologjinë e testimit, duke theksuar testimin e pranimit.

Personeli i bashkive:

- një deri pesë punonjës në çdo zyrë tatimore bashkiake trajnohen në nivel të avancuar për rregulloret dhe proceset e taksës së pronës;

- një deri pesë punonjës në çdo zyrë tatimore bashkiake trajnohen në nivel të avancuar në sistemin e TI-së për taksën e pronës;
- një deri pesë punonjës në çdo zyrë tatimore bashkiake janë të trajnuar në verifikimin e shitjeve fillestare;
- një deri pesë punonjës të çdo administrate tatimore vendore janë trajnuar në shërbimin e tatimpaguesit;
- një deri pesë punonjës të çdo administrate tatimore lokale trajnohen për njohuritë themelore të taksës së pronës (në mënyrë që të mund të shpjegojnë taksën e pronës për tatimpaguesit);
- një deri pesë punonjës në administratën tatimore vendore trajnohen për njohuri themelore të vlerësimit të pronës (në mënyrë që të mund të shpjegojnë vlerësimin për tatimpaguesit);
- të gjithë sa më sipër janë të trajnuar mbi mënyrën sesi të përdorin faqen e internetit të taksës së pronës;

2.5.9 Të tjera që duhen dorëzuar

Përveç sa më sipër, Projekti, gjithashtu, do të prodhojë produkte të tjera si dokumentacion, manuale dhe materiale trajnimi:

Dokumentacioni:

- modeli i procesit të biznesit;
- modeli i informacionit;
- fjalori i biznesit.

Manualet:

- manuali për regjistrimin e pronave;
- manuali për vlerësimin;
- manuali për grumbullimin.

Materiali trajnimi:

- material trajnimi për trajnimin e sistemit të TI-së;
- material trajnimi për rregulloret e taksës së pronës dhe trajnimin e proceseve;
- material trajnimi për trajnimin e vlerësimit;
- material trajnimi për trajtimin e shërbimit të tatimpaguesit.

Projektpropozimi

- projektpropozimi për taksën e tokës

2.6 Kufizimet:

- projekti nuk do të angazhohet në zgjidhjen e çështjeve të pronësisë ose në marrjen e pronësisë de facto të regjistruar ligjërish në ZRPP;
- projekti nuk do të përfshihet në regjistrimin ose vlerësimin e tokës (parcelës);
- nëse vendoset se shpërndarja e faturës tatimore dhe mbledhja duhet të bëhet nga bashkitë dhe jo së bashku me faturën e OSHEE-së, përgjegjësia e projekteve përfundon me dorëzimin e të dhënave të faturimit të bashkitë.

3. Kur | Planifikimi kohor

Faza I Sistem i konsoliduar i taksimit të pasurisë		Faza II Sistem i taksimit të pasurisë i bazuar në vlerën e tregut	
<i>Konceptimi</i> <i>T1 2018</i>	<i>Specifikimet</i> <i>T2-Q4 2018</i>	<i>Zbatimi</i> <i>2019</i>	<i>Kalimi</i> <i>2020</i>
<i>Projekti i themeluar</i> • Staf i punësuar • Zyra dhe pajisje të siguruar • Kuadri ligjor aktual i vlerësuar dhe rregulloret kalimtare të draftuara • Regjistri i OSHE është migruar • Mjedis i zhvillimit të IT është krijuar	<i>Eshtë zbatuar taksa e pronës mbi ndërtesat bazuar në vlerat sipas zonave fiskale</i> • Taksimi i parë mbështetur në të dhënat e OSHE • Fature e takses së pasurisë hartuar dhe paraqitur MFE • Taksapaguesit në bashkitë e taksuara janë në dijeni të implementimit të takses sipas vlerave të zonave fiskale • Versioni i parë i sistemit të IT për taksën e pronës është shpërndarë • Stafit në bashkitë është trajnuar	<i>Taksa e pasurisë bazuar në vlerën e tregut është gatshme për zbatim në janar 2020</i> • Ligji mbi taksën e pasurisë është aprovuar në parlament • Taksapaguesit janë në dijeni se do të zbatohet Taksa mbi ndërtesat bazuar në vlerën e tregut • Zonat e vlerës për gjithë bashkitë • Versioni i dytë i sistemit të IT për taksën e pronës së bashku me funksionalitetin CAMA është shpërndarë • Stafit në gjithë bashkitë i trajnuar	<i>Rezultatet e projektit marrë në dorëzim</i> • Taksapaguesit janë në dijeni mbi detyrimet individuale për taksën dhe mbi bazën përkatëse • Taksapaguesit janë në dijeni për shërbimin online në dispozicion • Procesi i regjistrimit, vlerësimit dhe mbledhjes së takses kaluar në MFE dhe bashkitë • Mirembajtja dhe operimi i IT kaluar shitesve private • Është draftuar propozimi i projektit për taksën e takës

3.1 Faza I

Faza I përfshin dy fazat e para të Projektit, fillimin dhe specifikimet. Është planifikuar të fillojë në muajin mars të vitit 2018.

Fokusi gjatë kësaj faze është krijimi dhe konsolidimi i një regjistri të taksës së pronës bazuar në regjistrin e OSHEE-së, duke përfshirë të dhënat e sondazhit, zbatimin e një sistemi TI të centralizuar të taksës së pronës dhe fillimin e taksimit të ndërtesave (njësive të objektit).

Gjithashtu, gjatë kësaj faze është specifikuar një zgjidhje afatgjatë për taksën e pronës bazuar në vlerën e tregut, p.sh. është hartuar një kuadër i ri legjislativ dhe janë hartuar proceset dhe metodat e reja të biznesit.

Prioriteti është cilësia dhe plotësia e regjistrave dhe jo rritja e të ardhurave nga taksa e pronës.

3.2 Faza II

Faza II përfshin dy fazat e fundit të Projektit, zbatimin dhe tranzicionin. Është planifikuar të përfundojë në dhjetor 2021.

Fokusi gjatë kësaj faze është zbatimi i një takse prone bazuar në vlerën e tregut të ndërtesave (njësive të objekteve) në të gjitha bashkitë në Shqipëri.

Gjithashtu, gjatë kësaj faze do të bëhet një propozim dhe përgatitja e taksës së tokës (parcelave).

Prioritet është qëndrueshmëria dhe, gjithashtu, rritja graduale e të ardhurave nga taksa e pronës.

3.3 Faza fillestare

Faza fillestare planifikohet të jetë përafërsisht tre muaj, duke filluar nga muaji mars 2018.

Objektivat kryesorë

Krijimi i Projektit:

- punësimi i personelit;
- zyra dhe pajisjet në vend;
- kuadri aktual ligjor i vlerësuar dhe aktet nënligjore kalimtare janë hartuar;
- regjistri i OSHEE-së është marrë;
- ambienti i zhvillimit të TI-së gati dhe përshtatja e sistemit të TI-së ka filluar.

Për një specifikim më të detajuar të rezultateve të Projektit të pritshme të kësaj faze, shihni bashkëlidhur Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

3.4 Faza e specifikimit

Faza specifikimeve është planifikuar që të kryhet nga muaji prilli në muajin dhjetor 2018.

Objektivat kryesorë

Zbatohen taksa për ndërtesat (njësitë e objektit):

- zbatimi i taksave të ndërtesave;
- ligji për taksën e pronës së paluajtshme i është dorëzuar MFE-së;
- publikimi i versionit të parë të një faqeje interneti për Taksën e Pronës;

- tatimpaguesit janë të vetëdijshëm se taksa e pronës bazuar në vlerën e zonës fiskale do të zbatohet për ndërtesat (njësitë e objekteve);

- është krijuar regjistri i taksës së pronës bazuar në regjistrin e OSHEE-së;
- zbatimi i versionit të parë të sistemit të centralizuar të TI-së së taksës së pronës;
- stafi i trajnuar në bashki.

Për një specifikim më të detajuar të rezultateve të pritshme të Projektit të kësaj faze, shihni bashkëlidhur Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

3.5 Faza e zbatimit

Faza e zbatimit planifikohet të kryhet gjatë vitit 2019.

Objektivat kryesorë

Taksa e pronës e bazuar në vlerën e tregut gati për t'u zbatuar në janar 2020:

- ligji mbi taksën e pasurisë së paluajtshme i miratuar nga parlamenti;
- tatimpaguesit janë të vetëdijshëm se do të zbatohet taksa e pronës bazuar në vlerën e tregut;
- shërbimet elektronike janë të disponueshme;
- vlera e zonave për ndërtesat në të gjitha bashkitë;
- versioni i dytë i sistemit TI të taksës së pronës me funksionalitetin CAMA;
- stafi në të gjitha bashkitë është i trajnuar për taksën e pronës të bazuar në vlerën e tregut.

Për një specifikim më të detajuar të rezultateve të pritshme të Projektit të kësaj faze, shihni bashkëlidhur Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

3.6 Faza e tranzicionit

Faza e tranzicionit është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2020.

Objektivat kryesorë

Rezultatet e Projektit dorëzohen në mënyrë konstante:

- tatimpaguesit janë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre individuale të taksave dhe bazën për to;
- tatimpaguesit janë të vetëdijshëm për shërbimet e disponueshme elektronike;
- procesi i regjistrimit kalon në bashki;
- vlerësimi i procesit ka kaluar MFE-në;
- procesi i taksave dhe i mbledhjes u kalua në MEF dhe në bashki;
- operimi dhe mirëmbajtja e TI-së u kalua te shitësi privat;
- propozim Projekti për taksën e tokës.

Për një specifikim më të detajuar të rezultateve të pritshme të Projektit të kësaj faze, shihni bashkëlidhur Matricën e Kuadrit Logjik të *ProTax Albania*.

4. Kush | Organizimi





Figura 4 Projekti është i organizuar në pesë grupe dhe është i rrethuar nga partnerët në të majtë dhe përfituesit në të djathtë.

4.1 Komiteti Drejtues

Komiteti Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Projektit. Ai vendos, pas miratimit nga SIDA, mbi ndryshimet e mundshme në planin kohor, rezultatet e Projektit dhe buxhetin e përcaktuar në këtë dokument. Ai miraton specifikimet dhe zbatimin e rezultateve të ndryshme të Projektit të propozuara nga Projekti në kuadër të marrëveshjes së zbatueshme ndërmjet qeverive të Shqipërisë dhe Suedisë.



Komiteti Drejtues është përgjegjës për furnizimin e Projektit me burime nga biznesi i zakonshëm, p.sh. stafi në MFE dhe bashkitë. Ai ka rol të rëndësishëm në arritjen e rezultateve të Projektit në biznes.

Për të forcuar aftësitë e tij vendimmarrëse, Komiteti Drejtues emëron dy grupe referimi, një për çështjet ligjore dhe një për çështjet e zhvillimit të biznesit.

Komiteti Drejtues do të mbledhet dy herë në vit.

Komiteti Drejtues përbëhet nga rolet e mëposhtme:


Roli	Përfaqësuesit
Kryetar	Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Anëtar	Ministri i Punëve të Brendshme
Anëtar	Bashkitë (deri në katër përfaqësues)
Anëtar	Përfaqësues nga IPRO, OSHEE dhe ASIG (mund të ndryshohen gjatë zhvillimit të Projektit)
Anëtar	Agjencia Tatimore Suedeze
Anëtar	SIDA
Anëtar	NAIS
Anëtar	GDT
Vëzhgues	IMF
Vëzhgues	EU

4.2 Njësia e zbatimit të Projektit

Për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve për Projektin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe SIDA do të krijojnë dhe në çdo kohë gjatë zbatimit të Projektit, operojnë një njësi për zbatimin e Projektit me burime të përshtatshme dhe personel të kualifikuar.

4.3 Grupi i Menaxhimit të Projektit (PMG)

Grupi i Menaxhimit të Projektit është organi ekzekutiv i Projektit. Ai ka mandatin për të marrë vendime brenda kuadrit të këtij plani të Projektit.




Grupi i Menaxhimit të Projektit përbëhet nga rolet e mëposhtme:

<i>Roli</i>	<i>Përgjegjësia</i>
Menaxheri i Projektit (PM)	Menaxhon të gjithë Projektin
Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Projektit	Ndihmon menaxherin e Projektit dhe është shefi i Grupit Ndërkombëtar
Grupi operativ suedez i Menaxherit të Projektit	Ndihmon menaxherin e Projektit (lokal), Menaxherin e Projektit të Grupit Ndërkombëtar dhe dy Ndihmës Menaxherët e Projektit
Ndihmës Menaxheri i Projektit për Zhvillimin e Biznesit	Menaxhon Grupin e Zhvillimit të Biznesit
Ndihmës Menaxheri i Projektit për Zhvillimin e TI-së	Menaxhon Grupin e Zhvillimit të TI-së
Koordinatori i Projektit	Koordinon dhe administron aktivitetet e Projektit

4.4 Grupi i Zhvillimit të Biznesit

Ekipi i Zhvillimit të Biznesit menaxhohet nga zëvendës-MP për Zhvillimin e Biznesit.

Ekipi i Zhvillimit të Biznesit ka përgjegjësinë kryesore për katër nga pesë rezultatet e Projektit, rregullat e avancuara të taksës së pronës, tatimpaguesit e përgatitur mirë, regjistrat gjithëpërfshirës të taksës së pronës dhe proceset e zbatuara të biznesit. Ai është, gjithashtu, përgjegjës për përcaktimin dhe verifikimin e kërkesave të nivelit të lartë në sistemin e TI-së.



Ekipi i Zhvillimit të Biznesit përbëhet nga rolet e mëposhtme:

<i>Roli</i>	<i>Përgjegjësia</i>
Zyrtarët e taksimit të pronës (Punësuar nga MFE-ja)	Kanë përgjegjësinë kryesore në hartimin e përgjithshëm të proceseve të reja të biznesit, përveç procesit të vlerësimit. Janë, gjithashtu, përgjegjës për modelin e <i>domen</i> -it dhe modelin e procesit të biznesit.
Ekspertët e taksimit të pronës	Kontribuojnë me përvojat nga zhvillimi i sistemit të taksimit të pronës në Kosovë. Ndihmojnë zyrtarët lokalë të taksës së pronës
Zyrtarë informacioni (Punësuar nga MFE-ja)	Kanë përgjegjësinë kryesore në rezultatin e Projektit tatimpaguesit të mirëpërgatitur dhe për komunikim të brendshëm. Gjithashtu, ata marrin pjesë në nxjerrjen e të gjitha rezultateve të tjera të Projektit.


Ekspertë për informimin e taksapaguesve	Kontribuojnë me përvojat e informacionit TP nga <i>ProTax</i> në Kosovë dhe Agjencia Tatimore e Zhvillimit. Ndihmon zyrtarët e informacionit.
Zyrtarë ligjorë (Punësuar nga MFE-ja)	Ka përgjegjësinë kryesore për rezultatin e Projektit rregulloret e përmirësuara të taksës së pronës. Gjithashtu, merr pjesë në prodhimin e rezultateve të tjera të Projektit.
Ekspertë ligjorë	Kontribuon me përvojat e zhvillimit të rregulloreve të taksës së pronës në Kosovë dhe me njohjen e rregulloreve tatimore suedeze në përgjithësi. Ndihmon zyrtarët ligjorë.
Zyrtarë vlerësimi (Punësuar nga MFE-ja)	Kanë përgjegjësinë kryesore në procesin e vlerësimit, d.m.th., në mbledhjen e të dhënave të shitjeve, krijimin e zonave të vlerës dhe hartimin e një modeli të ri vlerësimi. Koordinon sektorin e vlerësimit të sektorit privat.
Ekspertë vlerësimi	Kontribuon me përvojat nga procesi i Vlerësimit në Kosovë dhe me njohuritë e vlerësimit masiv të pronave suedeze në përgjithësi.
Ekspertë të tjerë	Ndihmon zyrtarët vendorë të vlerësimit Ekspertë të ndryshëm në ekipin ndërkombëtar: Eksperti i prokurimit, eksperti i komunikimit, koordinatori i vlerësimit të ekipit, dizajner grafik, prodhuesi i videove.
Interpretues/përkthyes	Ndihmon Projektin me interpretim (përkthim verbal) dhe përkthim me shkrim.

Do të jetë e nevojshme që MFE-ja të hapë pozicione të tjera afatgjata, si për shembull, kontrolluesi, gjatë dhe/ose pas Projektit.

4.5 Grupi i Zhvillimit të TI-së

Ekipi i Zhvillimit të TI-së menaxhohet nga zëvendës-MP i Zhvillimit të IT-së.

Ekipi i Zhvillimit të TI-së ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e sistemit të centralizuar të TI-së të Projektit. Ai është, gjithashtu, përgjegjës për pjesëmarrjen nga perspektiva e zgjidhjes në hartimin e proceseve të biznesit.



Ekipi i Zhvillimit të TI-së përbëhet nga dy lloje burimesh. Njëri është ekspert ndërkombëtar dhe njëri është (shërbime) të prokuruarat përmes një tenderi të hapur me ndihmën e Projektit.

Konsulentët ndërkombëtarë në ekipin e Zhvillimit të TI-së kanë përgjegjësi specifike në transferimin e njohurive të konsulentët lokalë kur ata bashkohen me ekipin pas prokurimit të planifikuar.

Nga faza e tranzicionit dhe pas mbylljes së Projektit, shitësi i shërbimeve të TI-së duhet të ketë përgjegjësinë e vetme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mundshëm të mëtejshëm të sistemit të TI-së për ndërtesat (njësitë e objekteve).

Shërbimet e TI-së duhet të prokurohen për të paktën pesë vjet dhe do të financohen nga MFE-ja.

Ekipi i Zhvillimit të TI-së përbëhet nga rolet e mëposhtme:

Roli	Përgjegjësia
Grupi Ndërkombëtar i Analistëve të sistemeve	Ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e kërkesave dhe mirëmban modelin e kërkesave deri në fazën e tranzicionit.
Analistë të sistemeve (Prokuruar si shërbim)	Ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e kërkesave dhe mirëmban modelin e kërkesave që nga fillimi i fazës së tranzicionit.
Grupi Ndërkombëtar i Arkitektëve të TI-së	Ka përgjegjësinë kryesore për arkitekturën e sistemit të TI-së dhe mirëmban modelin e dizajnit/projektimit nga fillimi i Projektit deri në fillimin e fazës së tranzicionit.
Arkitekt TI-je (Prokuruar si shërbim)	Ka përgjegjësinë kryesore për arkitekturën e sistemit të TI-së dhe mirëmban modelin e dizajnit/projektimit pas fazës së tranzicionit.
Ekspert i testimit dhe cilësisë	Ndihmon dhe jep këshilla për procesin e testimit dhe sigurimin e cilësisë së regjistrave dhe të tjera.
Menaxher i testimit (Prokuruar si shërbim)	Ka përgjegjësinë kryesore për procesin e testimit dhe mban modelin e testimit që nga fillimi i fazës së tranzicionit.
Programues	Zhvillon sistemin e TI-së sipas udhëzimeve të arkitektëve të TI-së.
Programues (Prokuruar si shërbim)	Zhvillon sistemin e TI-së sipas udhëzimeve të arkitektëve të TI-së.
Testues	Kryejnë teste të ndryshme të sistemit sipas udhëzimeve të ekspertëve të testeve dhe cilësisë.
Testues (Prokuruar si shërbim)	Kryejnë teste të ndryshme të sistemit të udhëhequr nga menaxheri i testeve.
Menaxher TI-je (Punësuar nga MFE-ja)	Përgjegjës që të ketë pajisjet elektronike dhe mjediset e duhura, më vonë edhe përgjegjës për prokurimin e shërbimeve TI të nevojshme.
Zyrtarë asistence (Punësuar nga MFE-ja)	Përgjegjës për t'iu përgjigjur pyetjeve të thjeshta të TI-së dhe biznesit nga përdoruesit dhe më tej çështjeve më komplekse të radhës së dytë.

4.6 Grupet rezervë

Ekipet e Burimeve përbëhen nga persona që nuk janë pjesë e Projektit kryesor, por janë të disponueshme për të për periudha më të shkurtra ose më të gjata. Ekipet e Burimeve përbëhen nga persona që nuk janë pjesë e Projektit kryesor, por janë të disponueshëm për të për periudha më të shkurtra ose më të gjata.



4.6.1 Përfaqësuesit e përdoruesit

Përfaqësuesit e përdoruesit janë tre persona që përfaqësojnë përdoruesit (gjithashtu, shfrytëzuesit menaxhues) në bashki. Funkzioni i tyre është shqyrtimi dhe verifikimi i kërkesave për sistemin e TI-së, si dhe hartimi i proceseve të reja të biznesit. Ata, gjithashtu, kryejnë testin e pranimit.

4.6.2 Grupi i Vlerësimit

Ekipi i Vlerësimit përbëhet deri në shtatë persona nga Shqipëria dhe Kosova. Qëllimi i tyre është që të ndihmojnë ekspertët vlerësues suedezë, MFE-ja dhe bashkitë në krijimin e hartave të zonave të vlerës dhe krijimin e një regjistri të çmimeve të shitjes. Ekipi i vlerësimit është marrë nga sektori privat.

Anëtarët e ekipit vlerësues do të punësohen përkohësisht nga Projekti dhe do të financohen nga SIDA.

Nga faza e tranzicionit dhe pas përfundimit të Projektit, shërbimet e vlerësimit privat duhet të prokurohen për të paktën pesë vjet dhe do të financohen nga MFE-ja.

4.6.3 Grupi i Sigurimit të Cilësisë

Ekipi i Sigurimit të Cilësisë përbëhet deri në pesë persona. Qëllimi i tyre është që të sigurojë cilësinë e të dhënave të ndryshme që mbledh Projekti, për shembull të dhënat e shitjeve dhe të verifikojë prodhime të ndryshme prej tij, për shembull vlerat e reja të vlerësuara.

Anëtarët e Ekipit të Sigurimit të Cilësisë do të punësohen përkohësisht nga Projekti dhe do të financohen nga SIDA.

4.7 Anëtarët e Grupeve Ndërkombëtare

Anëtarët e ekipit ndërkombëtar ndihmojnë homologët e tyre lokalë në arritjen e objektivave të Projektit.

<i>Roli</i>	<i>Homologët</i>
Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Projektit	Menaxheri lokal i Projektit
Grupi Operativ Ndërkombëtar i Menaxherit të Projektit	Menaxheri lokal i Projektit
Ndihmësmenaxheri i Projektit për Zhvillimin e Biznesit	-
Ndihmësmenaxheri i Projektit për Zhvillimin e TI-së	-
Ekspertët e taksimit të pronës	Zyrtarët e taksimit të pronës
Eksperti për informimin e taksapaguesit	Zyrtarët lokalë të informimit
Ekspertët ligjorë	Zyrtarët lokalë ligjorë
Ekspertët e vlerësimit	Zyrtarët lokalë të vlerësimit
Ekspertët e tjerë	-
Analisti i sistemeve	Analisti lokal i sistemeve (prokuruar si shërbim)
Arkitekti i TI-së	Arkitekti lokal i TI-së (prokuruar si shërbim)
Ekspert i testimit dhe i cilësisë	Menaxheri lokal i testimit (prokuruar si shërbim)
Programuesi	Programuesi lokal (prokuruar si shërbim)
Testuesi	Testuesi lokal (prokuruar si shërbim)

4.8 Partnerët



4.8.1 Zyrtarët e Taksave në Bashki

Projekti do të bashkëpunojë me 61 Zyrat Tatimore Bashkiake:

1. për të ndërtuar kapacitetin lokal për procesin e Regjistrimit
2. për të ngritur kapacitetin lokal për procesin e grumbullimit
3. për të siguruar se të dhënat e shitjeve mbledhen dhe verifikohen
4. për të siguruar se njohuritë e tyre për rrethanat lokale merren parasysh gjatë procesit të vlerësimit
5. për të siguruar se tatimpaguesit informohen saktë

4.8.2 Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP-ja)

Projekti do të bashkëpunojë me ZRPP-në për të krijuar integritet për të dhënat e pronës dhe shitjeve. Projekti gjithashtu do të varet nga të dhënat e zonës fiskale të ZRPP-së në Fazën I.

4.8.3 Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)

Projekti do të bashkëpunojë me NAIS për të siguruar që sistemi i TI-së ndjek parimet e hartimit të drejtuara prej tyre. NAIS do të organizojë faqen e internetit të taksës së pronës.

NAIS emëron një anëtar të komitetit drejtues.

4.8.4 Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

Projekti do të bashkëpunojë me ASIG për të gjitha çështjet që lidhen me krijimin e regjistrave të vjetër gjeohapësinorë të rinj dhe të zgjeruar.

4.8.5 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

Projekti do të bashkëpunojë me DPT-në për çështjet që lidhen me publikimin e informacioneve për qytetarët.

DPT emëron një anëtar të komitetit drejtues.

4.8.6 Agjencitë e Shërbimit të DPT-së

Administrata Tatimore e Shqipërisë përfshin 23 Agjenci Shërbimi.

Projekti do të bashkëpunojë me ta dhe do të ndërtojë kapacitete, në mënyrë që ata të mund t'i japin Tatimpaguesve (të Pronës) shërbim të mirë.

4.8.7 Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RRKGJC)

Projekti do të bashkëpunojë me RRKGJC për t'u integruar me regjistrat e tyre në mënyrë që të dhënat për personat fizikë, gjurmët e gishtave, adresat dhe të dhëna të tjera të jenë në dispozicion të Kadastrës Fiskale.

Projekti, gjithashtu, do të bashkëpunojë me RRKGJC për t'i bërë të publikojnë një shërbim për të kërkuar numrat e identifikimit me emrin, adresën etj.

4.8.8 Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)

Projekti do të bashkëpunojë me QKB për t'u integruar në regjistrat e tyre në mënyrë që të dhënat për personat juridikë të jenë në dispozicion të Kadastrës Fiskale.

Projekti, gjithashtu, do të bashkëpunojë me QKB-në për t'i bërë të publikojnë një shërbim për të kërkuar numra biznesi me emrin e shoqërisë, adresën etj.

4.8.9 Agjencia për Trajtimin e Pronës (ATP)

Projekti do të bashkëpunojë me AKKP-në për krijimin e hartave të zonës së vlerës. AKKP-ja furnizon Projektin me të dhënat e tyre për vlerat e pronave.

4.8.10 Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)

ALUIZNI furnizon Projektin me regjistrimet e tyre të ndërtesave pa leje.

4.8.11 Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)

OSHEE-ja është distributor i energjisë elektrike në pronësi të shtetit.

OSHEE-ja do të sigurojë që Projekti të regjistrohet me klientët e tij, duke përfshirë informacionin për ndërtesat (njësitë e objekteve). Mbledhja e taksës së pronës gjatë fazës së parë të Projektit do të bëhet mujore së bashku me faturën e energjisë elektrike.

4.8.12 Banka e Shqipërisë

Projekti do të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë për të bërë vlerat e vlerësuara të pronave të vlefshme si bazë për hipotekat.

4.9 Përfituesit

4.9.1 Tatimpaguesit

Tatimpaguesit janë përfituesit përfundimtarë ose konsumatorët përfundimtarë të të gjitha rezultateve të projekteve.

Të ardhurat në rritje të taksës së pronës do të investohen në shërbime më të mira bashkiake.

Tatimpaguesit gjithashtu do të fitojnë transparencë më të mirë në Administratën Tatimore të Pronës.

4.9.2 Ministria e Financave & Ekonomisë (MFE)

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të fitojë:

- Rritjen e kapacitetit në vlerësim
- Rritjen e kapacitetit në prokurimin e shërbimeve të TI-së
- Rritjen e kapaciteteve në proceset e tjera të biznesit

4.9.3 Zyrat e Taksave Bashkiake

Zyrat Tatimore Bashkiake do të fitojnë:

- Rritjen e kapacitetit në procesin e Regjistrimit
- Rritjen e kapacitetit në procesin e grumbullimit
- Rritjen e kapaciteteve në proceset e shërbimit të Tatimpaguesit
- Sistemi i TI-së për taksën e pronës që mbahet në mënyrë të centralizuar/në nivel qendror

4.9.4 ASIG-u

ASIG-u do të marrë të dhëna të ndryshme (shitjet e verifikuara, vlerat e zonave me nivelet e vlerave, etj) të prodhuara nga projekti dhe Kadastra Fiskale për publikim.

4.9.5 Aktorët e Tregut të Pasurive të Paluajtshme

Aktorët e tregut të pronës do të fitojnë një transparencë më të mirë në tregun e pronave falë faktit që informacioni i çmimeve të shitjes do të mbledhet, verifikohet dhe publikohet.

4.9.6 Aktorët e Tregut të Kredisë

Duke i bërë vlerat e vlerësuara të pronës të vlefshme si garanci për hipotekat, kreditimi do të bëhet më i lehtë dhe më i lirë.

Beneficiaries

Taxpayers

Ministry of Finance
& Economy
(MFE)

Municipal
Tax Offices

ASIG

Property Market
Actors

Credit Market
Actors

4.10 Personeli

4.10.1 Personeli i financuar nga Sida

Roli	Punonjës	Javë			
		Totali	2018	2019	2020
Ekspert i GIS-it	Sondazhe në terren	12	4	4	4
Ekspert Vlerësimi 1	Sondazhe në terren	31	11	10	10
Ekspert Vlerësimi 2	Sondazhe në terren	30	10	10	10
Ndihmës Menaxheri i Projektit për Zhvillimin/Programimin e Biznesit	Projekti	60	20	20	20
Ndihmës Menaxheri i Projektit për Zhvillimin/Programimin e TI-së	Projekti	77	27	25	25
Dizenjator Grafik	Projekti	78	26	26	26
Interpretues/Përkthyes	Projekti	50	20	20	10
Zhvillues/Programues TI-je	Projekti	153	55	49	49
Ekspert Ligjor	Projekti	77	27	25	25
Koordinator i Projektit	Projekti	156	52	52	52
Ekspertë të Taksimit të Pronës PTD	Projekti	26	8	12	6
Sigurues i Cilësisë 1	Projekti	156	52	52	52
Sigurues i Cilësisë 2	Projekti	156	52	52	52
Sigurues i Cilësisë 3	Projekti	156	52	52	52
Përfaqësues i përdoruesit 1	Projekti	12	4	4	4
Përfaqësues i përdoruesit 2	Projekti	12	4	4	4
Përfaqësues i përdoruesit 3	Projekti	12	4	4	4
Ekspert vlerësimi PTD	Projekti	24	6	12	6
Koordinator i Grupit të Vlerësimit	Projekti	18	6	12	
Konsulent vlerësues Shqipëri 1	Projekti	24	8	16	
Konsulent vlerësues Shqipëri 2	Projekti	24	8	16	
Konsulent vlerësues Shqipëri 3	Projekti	24	8	16	
Konsulent vlerësues Kosovë 1	Projekti	30	8	16	6
Konsulent vlerësues Kosovë 2	Projekti	30	8	16	6
Konsulent vlerësues Kosovë 3	Projekti	30	8	16	6
Producent video	Projekti	36	12	12	12
Ekspert Komunikimi	Agjencia Tatimore Suedeze	4	2	2	
Arkitekt TI	Agjencia Tatimore Suedeze	26	10	8	8
Ekspert Ligjor	Agjencia Tatimore Suedeze	6	2	2	2
Menaxher Operativ i Projektit/Arkitekt Biznesi	Agjencia Tatimore Suedeze	72	28	24	20
Ekspert prokurimesh	Agjencia Tatimore Suedeze	5	2	2	1
Menaxher i Projektit për Grupin Suedeze	Agjencia Tatimore Suedeze	31	11	10	10
Ekspert për Informimin e Taksapaguesve	Agjencia Tatimore Suedeze	92	32	30	30
Ekspert për Testimin & Cilësinë	Agjencia Tatimore Suedeze	68	24	22	22

Ekzistojnë tri grupe të ndryshme të stafit që financohen nga SIDA.

- Staf i Agjencisë Suedeze të Taksave që kryesisht ofron Projektin me njohuri në tatime, informacione për tatimpaguesit dhe zhvillim të TI-së.
- Staf i *Lantmäteriet*, i cili kryesisht ofron Projektin me njohuri në vlerësimin masiv.
- Staf i angazhuar për Projektin nga Kosova që ofron Projektin me njohuri në të gjitha fushat e ndryshme të zbatimit të reformës së taksës së pronës.

4.10.2 Personeli i punësuar nga MFE-ja

Roli	Javë			
	Totali	2018	2019	2020
Zyrtar asistence	130	26	52	52

Zyrtar Informacioni	156	52	52	52
Menaxher TI-je	78	26	26	26
Zyrtarë Ligjorë	78	26	26	26
Menaxher i Projektit /Drejtor i Njesisë	156	52	52	52
Zyrtarë i Taksimit të Pronës 1	156	52	52	52
Zyrtarë i Taksimit të Pronës 2	144	40	52	52
Zyrtarë i Taksimit të Pronës 3	130	26	52	52
Zyrtar Vlerësimi 1 MFE	156	52	52	52
Zyrtar Vlerësimi 2 MFE	144	40	52	52
Zyrtar Vlerësimi 3 MFE	130	26	52	52

5. Si | Qasja

5.1 Supozimet dhe pengesat

5.1.1 Supozimet bazë

1. Kërkesat e hartuara në dokumentin bashkëlidhur, kërkesat afatshkurtra të *ProTax Albania*, plotësohen në kohë për taksimin e parë në vitin 2018.
2. Të gjitha palët e përfshira pranojnë përgjegjësinë sipas skemës organizative në kapitullin 4 të këtij dokumenti.
3. Plani kohor i Projektit bazohet në supozimin se propozimi i Projektit është miratuar jo më vonë se muaji dhjetor 2017.
4. Prokurimet e shërbimeve afatgjata të IT-së dhe vlerësimit që fondet e MFE-së realizohen sipas rregullave të prokurimit shqiptar dhe asistohen nga anëtarët e ekipit suedez.
5. Prokurimi i shërbimeve afatshkurtra dhe pajisjeve që fondet e SIDA-s realizohen sipas rregullave të prokurimit suedez.
6. Të gjithë punonjësit e përkohshëm të Projektit të financuar nga SIDA emërohen nga ekspertë suedezë nga Agjencia Tatimore Suedeze dhe *Lantmäteriet*.
7. Të gjitha bashkitë janë të lidhura me rrjetin qeveritar
8. Të gjitha pajisjet etj., të prokuruar nga Projekti do t'u dhurohen disa bashkive pas përfundimit të Projektit.
9. Projekti organizon hapësirë për zyre dhe pajisje për ekipin ndërkombëtar.

5.1.2 Ministria e Financave dhe Ekono-misë (MFE)

1. MFE-ja është organi zbatues dhe merr përsipër përgjegjësinë e plotë për Projektin.
2. MFE-ja emëron kryetarin dhe nënkryetarin e Komitetit Drejtues.
3. MFE-ja krijon një Njësi për Zbatimin e Projektit që vepron si punëdhënës formal i të gjithë personelit të Projektit të angazhuar përkohësisht.
4. MFE-ja krijon një Kadastër Fiskale me përgjegjësi sipas kapitullit 2.5 të këtij dokumenti.
5. MFE-ja garanton që Kadastra Fiskale dhe Projekti të kenë akses në të dhënat e nevojshme nga agjencitë e tjera.
6. MFE-ja organizon hapësirë për zyrë dhe banka për stafin e MFE-së të emëruar për Kadastrën Fiskale.
7. MFE-ja organizon hapësirë për zyrë dhe tavolinë për një koordinator Projekti të angazhuar nga Projekti.
8. MFE-ja siguron pajisje dhe infrastrukturë për stafin e MFE-së të emëruar për Kadastrën Fiskale (kompjutera, lidhje interneti, dërrasë/ tabelë e bardhë, projektues etj.).
9. MFE-ja emëron pozicionet e mëposhtme që nga faza e fillimit tashmë:
 - menaxheri i Kadastrës Fiskale (i njëjti person si MP lokal);
 - zyrtari ligjor;
 - zyrtari i taksës së pronës/zhvillues biznesi;
 - menaxher TI (me kohë të pjesshme dhe ndoshta i punësuar pranë AKSHI-t);
10. MFE-ja emëron pozicionet e mëposhtme në kohë të mjaftueshme para fazës së tranzicionit 2020:
 - zyrtari për informimin e tatimpaguesit;
 - zyrtarët e vlerësimit;
 - zyrtarët e mbledhjes;
 - kontrollorët;
 - zyrtarët e asistencës (sportelit).

11. Anëtarët e ekipit suedez veprojnë si vëzhgues me “Pushtet pa kundërshtim” gjatë rekrutimit të stafit të zakonshëm që emërohen në pozicione sipas pikave të mësipërme.
12. MFE-ja prokuron shërbimet e konsulentëve IT, duke filluar nga jo më vonë se muaji korrik.
13. MFE-ja është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit jo më vonë se muaji janar 2020.
14. Anëtarët e ekipit suedez ndihmojnë në proceset e prokurimit si këshilltarë.

5.1.3 Bashkitë

1. Bashkitë pranojnë përgjegjësinë për procesin e regjistrimit (anketa, zotëruesit e regjistrave etj.).
2. Bashkitë marrin pjesë në procesin e vlerësimit dhe pranojnë përgjegjësinë për verifikimin fillestar të shitjeve.
3. Bashkitë pranojnë përgjegjësinë për pjesë të procesit të grumbullimit (dërgojnë faturë, zbatojnë etj.).
4. Bashkitë pranojnë përgjegjësinë për takimin fizik të tatimpaguesit (dhënien e shërbimit).
5. Bashkitë caktojnë burime për detyrën e mësipërme dhe ato vendosen në dispozicion të Projektit për të mësuar.
6. Bashkitë e furnizojnë administratën lokale të taksës së pronës me hapësira dhe pajisje zyre.

5.1.4 Ministria e Financave në Kosovë

1. Nëpunësit civilë në Ministrinë e Financave në Kosovë marrin leje kur punojnë për *ProTax Albania*, siç është planifikuar në dokumentin e bashkëlidhur të stafit.
2. Konsulentët që punësohen për Projektin *ProTax 2* në Kosovë mund të përdorin hapësirën e zyrës dhe pajisjet e tyre në Kosovë edhe kur punojnë për *ProTax Albania*, siç është planifikuar në dokumentin e bashkëlidhur të personelit dhe planifikimit.

5.1.5 OSHEE-ja

1. OSHEE-ja furnizon Projektin me të dhënat e digjitalizuara për ndërtesat (njësitë e objekteve) në dispozicion të tyre.
2. OSHEE-ja mbledh taksën e pronës çdo muaj në të njëjtën faturë që përdoret për mbledhjen e tarifës së energjisë elektrike (deri në fazën e tranzicionit kur taksa e pronës planifikohet të faturohet veçmasi).
3. OSHEE-ja ndihmon në integrimin e sistemeve të IT-së për shkëmbimin e të dhënave të faturimit dhe pagesës.

5.1.6 Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP)

1. ZRPP-ja furnizon (*offline*) projektin dhe Kadastrën Fiskale me të gjitha të dhënat e digjitalizuara në zonat fiskale në dispozicion të tyre që nga fillimi i projektit.
2. ZRPP-ja furnizon (*offline*) projektin dhe Kadastrën Fiskale me të gjitha të dhënat e digjitalizuara për transaksionet e pronave në dispozicion të tyre që nga fillimi i projektit.
3. ZRPP-ja furnizon (jashtë linje) Projektin dhe Kadastrën Fiskale me të gjitha të dhënat e digjitalizuara mbi transaksionet pronësore që janë në dispozicion të tyre që nga fillimi i Projektit.
4. ZRPP-ja furnizon (*offline*) Projektin dhe Kadastrën Fiskale me të gjitha të dhënat e digjitalizuara për pronat, pronësinë etj., në dispozicion të tyre që nga fillimi i Projektit.
5. ZRPP-ja ndihmon në integrimin e sistemeve të IT-së për dërgimin e të dhënave të pronës *online* në Kadastrën Fiskale.

5.1.7 Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)

1. AKSHI cakton një anëtar për Komitetin Drejtues.
2. AKSHI merr përgjegjësinë për mbajtjen dhe funksionimin e sistemit të IT-së për taksën e pronës.
3. AKSHI merr përgjegjësinë për mbajtjen dhe funksionimin e faqes së internetit për taksën e pronës.

5.1.8 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT)

1. Agjencitë e Shërbimit të DPT-së ofrojnë shërbime të taksës së pronës (fizike) të tatim-paguesit.
2. DPT-ja ka vënë stafin e Agjencisë së Shërbimit në dispozicion të projekteve për trajnime.
3. DPT-ja ofron shërbimin e *call center* (qendrës së teleshitjeve) për taksën e pronës së *call center* të tatimpaguesit.
4. DPT-ja ka vënë stafin e *call center* (qendrës së teleshitjeve) në dispozicion të Projektit për trajnime.

5.1.9 Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC)

1. RKGJC-ja furnizon Kadastrën Fiskale me të dhënat e nevojshme për personat fizikë dhe adresat në dispozicion të tyre.
2. RKGJC-ja lejon Kadastrën Fiskale për të përdorur shërbimin e internetit për personat fizikë dhe adresat e tyre.

5.1.10 Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)

1. QKB-ja furnizon Kadastrën Fiskale me të dhënat e nevojshme për personat juridikë dhe adresat

në dispozicion të tyre.

2. QKB-ja lejon Kadastrën Fiskale për të përdorur shërbimin e internetit për të dhënat e personave juridikë dhe adresat e tyre.

5.1.11 Agjencia për Trajtimin e Pronës (ATP)

1. AKKP-ja furnizon Kadastrën Fiskale me të dhënat e nevojshme për vlerat e pronave në dispozicion të tyre.

5.1.12 ALUIZNI

1. ALUIZNI furnizon Kadastrën Fiskale me të dhënat e nevojshme për ndërtesat pa leje në dispozicion të tyre.

5.2 Ndjekja

Projekti do t'u nënshtrohet procedurave të rishikimit të SIDA-s. Proceset e planifikimit dhe monitorimit duhet të jenë brenda kuadrit logjik të Projektit.

5.2.1 Raporti i Komitetit Drejtues

Projekti duhet t'i raportojë Komitetit Drejtues në kohë të mjaftueshme para çdo takimi.

Raporti duhet të përfshijë:

- progresin në të ardhurat e taksës së pronës të grumbulluara në nivel kombëtar, si dhe në nivel bashkie;

- progresin për qëllime të tjera zhvillimore;
- Progresin në rezultatet e Projektit;
- progresin në menaxhimin e rrezikut;
- vendime të rëndësishme të marra nga menaxhimi i Projektit;
- propozimet që do të vendosen nga Komiteti Drejtues;
- ndjekja e buxhetit, duke përfshirë një parashikim për Projektin dhe një parashikim për vitin aktual.

5.2.2 Raporti vjetor

Projekti do të raportojë çdo vit te SIDA, në muajin mars.

Raporti vjetor duhet të përfshijë:

- progresin për qëllimet e zhvillimit;
- progresin për rezultatet e Projektit;
- progresin për menaxhimin e rrezikut;
- vendime të rëndësishme të marra nga menaxhimi i Projektit ose Komiteti Drejtues;
- raport për misionet e realizuara dhe vizitat studimore;
- ndjekja e buxhetit, duke përfshirë një parashikim për Projektin dhe një parashikim për vitin aktual;
- raporti i auditimit.

Nëse ndodhin incidente të paparashikuara që mund të ndikojnë në kohën, buxhetin ose rezultatin e Projektit, kjo do të raportohet në mënyrë të posaçme.

5.2.3 Takimi vjetor për ndjekjen

Çdo vit, gjatë tremujorit të dytë të vitit, një takim vijueshmërie do të zhvillohet në Tiranë, Shqipëri. Në takim do të marrin pjesë përfaqësues nga MFE-ja, SIDA/Ambasada e Suedisë dhe Agjencia Suedeze e Taksave.

5.2.4 Rishikimi afatmesëm

Gjatë vitit 2019, Projekti do të jetë subjekt i një rishikimi afatmesëm të financuar dhe menaxhuar nga SIDA.

5.2.5 Raporti përfundimtar

Pas përfundimit të Projektit, Projekti do të dorëzojë një raport përfundimtar te SIDA. Ky raport do të dorëzohet, gjithashtu, te MFE-ja.

5.3 Aspektet mjedisore të zbatimit të Projektit

Agjencia Suedeze e Taksave ka një sistem menaxhimi mjedisor që, së bashku me një politikë mjedisore, është pjesë përbërëse e biznesit.

Gjatë zbatimit të këtij Projekti, ekzistojnë disa aspekte mjedisore që konsiderohen thelbësore. Në radhë të parë, është ndikimi mjedisor i udhëtimit ajror, por edhe aspektet mjedisore kur blen mallra dhe shërbime. Fluturimet e ekspertëve dhe vizitat studimore do të koordinohen dhe planifikohen në mënyrë që ata të kenë ndikimin më të vogël mjedisor. Mundësitë për të shfrytëzuar takimet me anë të transmetimit video duhet të kenë prioritet. Projekti, gjithashtu, do të jetë i kujdesshëm me konsumin e burimeve të tjera të fundme natyrore.

5.4 Vizitat studimore

5.4.1 Vizitat studimore të Komitetit Drejtues

Janë planifikuar dy vizita studimore për Komitetin Drejtues. Qëllimi i vizitës është të japë një pasqyrë të përgjithshme mbi mënyrën sesi *Lantmäteriet*, Agjencia Tatimore Suedeze punon në lidhje me taksën e pronës, pra tarifën e pronësisë. Vizita e parë studimore do të fokusohet në planifikimin/drejtimin e Projektit dhe vizita e dytë në vlerësimin e tij dhe planifikimin për hapat e mëtejshëm pas Projektit.

5.4.2 Vizita studimore për taksimin e pronës

Një vizitë studimore është planifikuar për zyrtarët në MFE dhe stafin e Projektit. Qëllimi i vizitave është dhënia e njohurive në tatimin në pronë në përgjithësi në *Lantmäteriet* dhe Agjencinë Suedeze të Taksave.

5.4.3 Vizitat studimore për vlerësimin

Janë planifikuar dy vizita studimore për oficerët e vlerësimit nga MFE dhe Projekti. Qëllimi i vizitave është të japë njohuri të thelluara në metodologjinë e vlerësimit dhe vlerësimin masiv në *Lantmäteriet* dhe Agjencinë Suedeze të Taksave.

5.4.4 Vizita studimore për zhvillimin e TI-së

Një vizitë studimore është planifikuar për zhvilluesit e TI-së të punësuar nga Projekti dhe stafi TI në MFE dhe NAIS. Qëllimi i vizitave është të thellojë njohjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e TI-së në *Lantmäteriet* dhe Agjencinë Suedeze të Taksave.

5.4.5 Vizitat studimore në Kosovë

Vizitat studimore në Kosovë do të organizohen për grupe të ndryshme të synuara si p.sh.: Komiteti Drejtues, vlerësuesit, stafi i Kadastrës Fiskale, përfaqësuesit e bashkisë dhe stafi i taksës së pronës.

5.4.6 Vizitat e biznesit

Për të lehtësuar punën, stafi rajonal do të udhëtojë për në Suedi për të kryer punën e zakonshme së bashku me anëtarët e ekipit suedez në Agjencinë Suedeze të Taksave dhe *Lantmäteriet*.

5.5 Konferencat

5.5.1 Konferencat e Komitetit Drejtues

Dy konferenca me drekë me Komitetin Drejtues janë planifikuar të mbahen në rajon.

5.5.2 Konferencat e Projektit

Tri konferenca me drekë janë planifikuar të zhvillohen në rajon në kuadër të Projektit.

5.5.3 Konferencat e përfaqësuesve të bashkive

Dy konferenca me drekë me përfaqësues të bashkive janë planifikuar të zhvillohen në nivel lokal.

5.6 Trajnimet

5.6.1 Trajnimet e reja për proceset dhe rregulloret e biznesit

Trajnimet në proceset dhe rregulloret e reja të biznesit do të zhvillohen për zyrtarët e Bashkisë në raste të ndryshme nga viti 2018 deri në vitin 2020.

5.6.2 Trajnimet e përdoruesve të IT-së

Trajnimet e përdoruesve të IT-së do të zhvillohen për zyrtarët e bashkisë, në raste të ndryshme nga viti 2018 deri në vitin 2020.

5.6.3 Trajnimi për verifikimin e shitjeve

Trajnimi në verifikimin (filleshtar) të shitjeve do të zhvillohet për zyrtarët e bashkisë më 2018-ën.

5.6.4 Trajnimet për shërbimin e tatimpaguesve

Trajnimet në shërbim të tatimpaguesve do të zhvillohen për zyrtarët e Bashkisë në raste të ndryshme gjatë viteve 2018 dhe 2019.

5.6.5 Trajnimet bazë për taksimin e pronës

Trajnimet themelore të taksës së pronës do të zhvillohen për zyrtarët e Bashkisë në raste të ndryshme gjatë viteve 2018 dhe 2019.

5.6.6 Trajnimet bazë për vlerësimet

Dy trajnime bazë vlerësimi dhe të veçanta do të zhvillohen për zyrtarët e Bashkisë në raste të ndryshme gjatë viteve 2019 dhe 2020.

5.6.7 Trajnimi për faqen e internetit të taksimit të pronës

Trajnimet mbi mënyrën sesi duhet të përdoret faqja e internetit të taksës së pronës, do të zhvillohen për zyrtarët e Bashkisë në raste të ndryshme gjatë viteve 2019 dhe 2020.

6. Nëse | Risqet

Për një deklaratë të plotë të të gjitha rreziqeve të identifikuar aktualisht, shihni Matricën e Riskut të *ProTax Albania*.

Pesë rreziqet më të larta përshkruhen më poshtë.

R009 Mospranimi nga taksapaguesit

Pranimi i tatimpaguesit për taksën e pronës është thelbësor për suksesin e reformës.

Për të zvogëluar këtë rrezik Projekti duhet të fokusohet në:

- informacione të hollësishme për tatimpaguesit
- edukimin e zyrtarëve të taksës së pronës në shërbimin e tatimpaguesit
- komunikimin me tatimpaguesit në lidhje me ekspozitën e planifikuar ku shpjegohet pse, si dhe kur do të zbatohet vlerësimi i objekteve. Më tej, ky vlerësim do të bëhet shumë transparent;
- përgatitjet e kujdesshme për të shmangur gabimet që mund të dëmtojnë besimin

R012 Mungesa e të dhënave të objekteve në regjistrin e OSHEE-së

Të gjitha njësitë më të largëta të objektit kanë të dhëna për zonën etj., në regjistrin e OSHEE-së. Dhe koha është shumë e kufizuar për ta plotësuar atë nga burime të tjera para taksimit të parë.

Për të zvogëluar këtë rrezik Projekti, duhet:

- të zbatojë një rregull kalimtar që lejon taksimin bazuar në një zonë dhe përdorim të supozuar;
- të informojë tatimpaguesit se ata mund të ankohen në zyrat e Bashkisë për të rregulluar taksën e tyre;
- Projekti, gjithashtu, duhet të përpiqet të përdorë burime të tjera të të dhënave si për shembull ZRPP-ja dhe regjistrimet e Bashkisë.

R025 Mungesa e burimeve në bashkitë

Burimet në bashki duhet të jenë të disponueshme për t'u kujdesur për regjistrimin, informacionin dhe ankesat menjëherë pas fillimit të taksimit.

Kritja e efikasitetit të administrimit të taksës tatimore do të zbusë këtë rrezik, por ende duhet të ndërmerren hapa nga MFE-ja dhe bashkitë për të siguruar stafin e duhur.

Bashkitë duhet të angazhohen nga fillimi që të kenë kohë për të gjetur burime dhe t'i bëjnë ato të disponueshme për trajnim nga Projekti.

Për të zbutur rrezikun, Projekti mund të ndihmojë përkohësisht edhe disa bashki në detyrat e tyre.

R026 Vështirësi për marrjen e personelin për mirëmbajtjen dhe operimin e IT-së

Është e vështirë për agjencitë publike që të rekrutojnë dhe mbajnë staf të kualifikuar IT-je. Stafi i IT-së i sponsorizuar nga MFE-ja do të jetë i nevojshëm në pjesët e mëvonshme të Projektit dhe natyrisht do të jetë përgjegjës vetëm pas përfundimit të Projektit.

Për të zvogëluar këtë rrezik, stafi i IT-së duhet të prokurohet si shërbim në vend të punësimit të stafit. Për të siguruar cilësinë e duhur të këtyre shërbimeve, Projekti do të ndihmojë në hartimin e tenderave dhe marrëveshjes së mundshme të Nivelit të Shërbimit.

R033 Pritjet joreale në planin kohor

Plani kohor, veçanërisht për taksimin e parë është shumë optimist dhe edhe nëse Projekti menaxhohet në kohë do të jetë një zbatim me shumë rreziqe dhe ndoshta me cilësi të ulët. Projekti duhet të informojë MFE-në për të siguruar që ata do të marrin vendime të mirë-bazuara në kohën e taksimit të parë të objekteve.

Tatimpaguesit do të informohen për situatën me cilësi të ulët të të dhënave në lidhje me taksimin e parë.

7. Sa | Buxheti

Për detaje mbi buxhetin, shihni buxhetimin dhe stafin e *ProTax Albania*.

Vini re se buxheti i detajuar është vetëm për qëllime llogaritjeje. Menaxhimi i Projektit lejohet të lëvizë kostot midis zërave nën nivelin kumulativ të paraqitur më poshtë.

	Buxheti total
TARIFAT	11 899 900 SEK
Agjencia Tatimore Suedeze	
Nëntotali	11 899 000 SEK
RIMBURSIMET	1 927 000 SEK
Agjencia Tatimore Suedeze	
Nëntotali	1 927 000 SEK
KOSTOT E MISIONIT	22 455 000 SEK
Lantmäteriet	
Nëntotali	3 964 000 SEK
Konsulentët rajonalë	
Nëntotali	9 242 000 SEK
Vizita studimore dhe vizita pune	
Nëntotali	1 854 000 SEK
Shërbimi i tatimpaguesve	
Nëntotali	5 558 000 SEK
Konferencat dhe trajnimet	
Nëntotali	1 111 000 SEK
Transporti lokal	
Nëntotali	276 000 SEK
Auditimi	
Nëntotali	150 000 SEK
Të paparashikuara	
Nëntotali	300 000 SEK
TOTALI	36 281 000 SEK

7.1 Buxheti vjetor

	2018	2019	2020
TARIFAT	4 234 000 SEK	3 922 000 SEK	3 743 000 SEK
Agjencia Tatimore Suedeze			
Nëntotali	4 234 000 SEK	3 922 000 SEK	3 743 000 SEK
RIMBURSIMET	766 000 SEK	605 000 SEK	556 000 SEK
Agjencia Tatimore Suedeze			
Nëntotali	766 000 SEK	605 000 SEK	556 000 SEK
KOSTOT E MISIONIT	7 352 000 SEK	8 954 000 SEK	6 149 000 SEK
<i>Lantmäteriet</i>			
Nëntotali	1 337 000 SEK	1 323 000 SEK	1 304 000 SEK
Konsulentët rajonalë			
Nëntotali	2 982 000 SEK	3 735 000 SEK	2 525 000 SEK
Vizita studimore dhe vizita pune			
Nëntotali	877 000 SEK	587 000 SEK	390 000 SEK
Shërbimi i tatimpaguesve			
Nëntotali	1 509 000 SEK	2 607 000 SEK	1 442 000 SEK
Konferencat dhe trajnimet			
Nëntotali	405 000 SEK	460 000 SEK	246 000 SEK
Transporti lokal			
Nëntotali	92 000 SEK	92 000 SEK	92 000 SEK
Auditimi			
Nëntotali	50 000 SEK	50 000 SEK	50 000 SEK
Të paparashikuara			
Nëntotali	100 000 SEK	100 000 SEK	100 000 SEK
TOTALI	12 352 000 SEK	13 481 000 SEK	10 448 000 SEK

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME TË SIDA-s PËR BASHKËPUNIM ME AUTORITETET

§ 1. Përkufizime

- “Bashkëpunim me një autoritet” do të thotë bashkëpunim ndërmjet autoriteteve publike në Suedi dhe në vendet partnere dhe/ose organizatat ndërkombëtare, të financuara plotësisht ose pjesërisht nga SIDA.
- “Partner bashkëpunimi” do të thotë partneri i Autoritetit Suedez në vendin partner (ministra/autoriteti/organizata).
- “Staf” do të thotë personat e punësuar nga Autoriteti Suedez ose nënkonsulentët e Autoritetit Suedez.
- “Qeveri” do të thotë qeveria në vendin partner.
- “Marrëveshje Kontributi” do të thotë marrëveshja e SIDA-s/Suedisë me një autoritet/ organizatë në vendin partner.
- “Marrëveshje ndërmjet Agjencive për blerjen e shërbimeve” do të thotë një marrëveshje ndërmjet Autoritetit Suedez dhe SIDA-s.
- “Marrëveshje Projekti” do të thotë një marrëveshje ndërmjet një Autoriteti Suedez dhe/ose një autoriteti ose një organizate në një vend partner.

§ 2. Zbatueshmëria e kushteve të përgjithshme

Këto kushte të përgjithshme për bashkëpunimin me një autoritet tregojnë kushtet për financimin nga SIDA dhe janë të vlefshme nëse nuk është rënë dakord asgjë tjetër ndryshe në Marrëveshjen e Kontributit ose në Marrëveshjen midis agjencive për blerjen e shërbimeve.

§ 3. Përshkrimi i bashkëpunimit/Projektit/ programit

Objekti i bashkëpunimit do të përshkruhet në një dokument të Projektit/programit, duke përfshirë kuadrin e rezultateve ku janë përcaktuar synimet për Projektin/programin, si dhe janë specifikuar treguesit e ndjekjes së mëtejshme. Qëllimet për Projektin/programin duhet të specifikojnë se çfarë duhet të dorëzohet (produkti), çfarë do të arrihet në afat të shkurtër dhe të mesëm (rezultati) dhe efekti që duhet të arrihet në planin afatgjatë (ndikimi). Qëllimet e niveleve të produktit dhe rezultatit duhet të jenë të matshme. Dokumenti i Projektit/programit duhet të përmbajë edhe një analizë të risqeve kryesore në lidhje me rëndësinë, realizueshmërinë, efektivitetin e kostos dhe kapacitetin financiar të Projektit/ programit, si dhe mënyrën sesi do të trajtohen këto risqe.

§ 4. Buxheti

Për çdo detyrë individuale do të ketë një buxhet të ndarë në tarifa, në shpenzime të rimbursueshme dhe kosto Projekti. Buxheti duhet të paraqesë kostot për nënkomponentë/nënqëllime të ndryshme bashkëpunimi, të përshtatura në përputhje me parimet e shtojcës A.

Me kusht që të mos jetë rënë dakord për asgjë tjetër në një detyrë individuale, Autoriteti Suedez, me miratimin e palës bashkëpunuese lokale, mund të rishpërndajë shumat *brenda* zërave të buxhetit për tarifa, kosto të rimbursueshme dhe kosto të detyrës, në qoftë se justifikohen për të arritur rezultate më të mira. Për transferimin e shumave të buxhetit midis zërave buxhetorë për tarifë, kostot e rimbursueshme dhe kostot e detyrës, si dhe për shfrytëzimin e zërit të buxhetit “Kostot e papritura”, kërkohet miratimi i SIDA-s.

Rialokimi në buxhetin fillestar, si dhe arsyeja për këtë, do të përcaktohet në raportin vjetor financiar.

§ 5. Staf i Autoritetit Suedez

Autoriteti Suedez do të sigurojë personel me përvojën dhe kualifikimet e nevojshme për të kryer detyrën/bashkëpunimin. Autoriteti Suedez do të njoftojë SIDA-n për emrat, arsimin, aftësitë e veçanta dhe kualifikimet e personave kryesorë. Nëse detyra do të realizohet për një periudhë më të gjatë se një vit, Autoriteti Suedez do të përditësojë SIDA-n në përputhje me rrethanat, pasi detyra kërkon që të angazhohet staf i ri. Autoriteti Suedez është përgjegjës për personelin e nënkontraktuar sikur të ishte staf i saj. Miratimi i vendit të bashkëpunimit për stafin do të trajtohet në marrëveshje midis Autoritetit Suedez dhe autoritetit/organizatës së vendit partner.

§ 6. Miratimi i ndryshimeve të stafit

Autoriteti Suedez, pa vonesë, do të informojë palën e tij bashkëpunuese dhe SIDA-n nëse nevojitet zëvendësimi i stafit kryesor. Pas konsultimit me Autoritetin Suedez, SIDA mund të kërkojë ndryshim stafi nëse dikush, për shkak të arsyeve objektive, rezulton të jetë i papërshtatshëm ose nuk pranohet nga partneri i bashkëpunimit. Autoriteti Suedez duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përmbushur kërkesën sa më parë që të jetë e mundur.

§ 7. Tarifat

Tarifat për Autoritetin Suedez do të përcaktohen duke filluar nga parimi i mbulimit të kostos së plotë në përputhje me llogaritjet vjetore të autoritetit. Një tarifë në këtë model llogaritjeje përfshin kryesisht pagat, përfitimet e punonjësve, pensionet, pagesën e pushimeve dhe kostot operative/administrative. Çdo ndryshim i tarifave, bazuar në të njëjtin model llogaritjeje, do të merret në konsideratë në konsultimet vjetore midis Autoritetit Suedez dhe SIDA-s.

Koha e punës në Suedi paguhet me orë. Puna jashtë Suedisë, duke përjashtuar stafin me kontratë afatgjatë, paguhet me javë. Stafi i punësuar në detyra afatgjata, që do të thotë detyra që zgjasin mbi dymbëdhjetë muaj, paguhet në bazë mujore. Javët e pjesshme paguhen me ditë, me 1/5 e pagës javore, me përjashtim të kohës së udhëtimit dhe muajt e pjesshëm paguhen me ditë me 1/21 e pagës mujore. SIDA nuk rimbursion punën jashtë orarit.

Kompensimi bëhet për kohën faktike të udhëtimit, duke filluar nga parimi i një dite pune 8-orëshe.

Kostot që nuk janë shprehimisht të rimbursueshme sipas pikës § 8 ose lidhen me kostot e detyrave sipas pikës § 9 më poshtë konsiderohen si pjesë e tarifës.

§ 8. Kostot e rimbursueshme

Kostot e rimbursueshme janë kosto që janë të lidhura drejtpërdrejt me stafin e ofruar nga Autoriteti Suedez. SIDA do të rimbursojë këto kosto, nëse ato nuk rimbursohen nga pala bashkëpunuese.

Kostot e mëposhtme janë të rimbursueshme:

- kostot për udhëtime biznesi vendëse ose ndërkombëtare (udhëtimi, hoteli dhe dietat) sipas rregullave të qeverisë për udhëtime biznesi;

- për udhëtimet e biznesit jashtë vendit, SIDA do të paguajë një biletë me çmimin më të ulët në dispozicion sipas IATA-s. Gjithmonë do të shfrytëzohen mundësitë për çmimet më të mira, zbritjet dhe marrëveshjet e kuadrit shtetëror. SIDA mund të paguajë kostot për fluturimet në klase të tjera në rrethana të veçanta, si arsyet mjekësore të dokumentuara;

- shpenzimet për udhëtime lokale si pjesë e Projektit;

- shpenzimet për postën ndërkombëtare, tele-komunikacionin dhe TI-në;

- shpenzime të tjera që lidhen me stafin në përputhje me marrëveshjen kolektive të URA (*Marrëveshja për kontratat jashtë shtetit dhe udhëzimet për shërbime jashtë vendit*) ose rregulloret që mund të zëvendësojnë sa më lart.

Shpenzimet e tjera që lidhen me stafin e Autoritetit Suedez përfshihen në shpërblimin sipas § 7 më sipër, nëse asgjë tjetër nuk është rënë dakord në një detyrë individuale.

§ 9. Kostot e detyrës

“Kostot e detyrës” u referohen kostove që nuk lidhen me stafin e Autoritetit Suedez, por për të cilat Autoriteti Suedez mund të jetë përgjegjës në kuadrin e financimit të SIDA-s, p.sh. konsulentët, kontributi i autoriteteve të tjera, blerja e pajisjeve, kostot lokale për seminare, konsulentët lokalë dhe udhëtimet studimore në Suedi ose në një vend të tretë. SIDA do të paguajë Autoritetin Suedez për kostot aktuale të detyrës si pjesë e buxhetit për një detyrë individuale.

Nëse, si pjesë e detyrës individuale, përfshihet mbështetja financiare nga SIDA për aktivitetet lokale të administruara nga organizata pritëse (të ashtuquajturat kontribute financiare), p.sh.: për blerjen e pajisjeve, operacionet e projektit me stafin lokal dhe trajnimin, Autoriteti Suedez duhet të sigurojë që organizata pritëse është përgjegjëse për zbatimin, kontabilitetin e kostos dhe raportimin tek Autoriteti Suedez për operacionet/veprimtaritë e kryera, nëse nuk është rënë dakord për asgjë tjetër në detyrën individuale.

§ 10. Faturimi dhe pagesa

Për çdo detyrë, do të dërgohet një faturë te SIDA, normalisht në fund të tremujorit, me kusht që të mos jetë rënë dakord për asgjë tjetër për detyrën individuale. Për detyrat që zgjasin më pak se gjashtë muaj, fatura do të dërgohet pas përfundimit të detyrës. Fatura të tilla duhet të shoqërohen me një raport përfundimtar për detyrën. Fatura përfundimtare do t'i dërgohet SIDA-s jo më vonë se katër muaj pas përfundimit të detyrës. Rimbursimi jashtë faturës përfundimtare nuk do të miratohet.

§ 10:1. Përmbajtja e faturës

Fatura duhet të tregojë llojin dhe qëllimin e punës së përfunduar dhe t'i referohet Projektit/ programit dhe subjektit përgjegjës SIDA ose ambasadës që cilësohet në detyrën individuale. Fatura duhet të përmbajë, gjithashtu, numrin e organizatës së Autoritetit Suedez, shumën e faturuar, datën dhe numrin e faturës, si dhe referencën të njësisë përgjegjëse SIDA. Të gjitha shumat e debituar duhet të përshkruhen qartë. Një përmbledhje do t'i bashkëngjitet çdo fature të shumave të faturuara të akumuluar në detyrë në raport me buxhetin e përgjithshëm dhe, ku është e zbatueshme, një përshkrim të qartë të devijimeve në lidhje me planin.

Faturimi duhet të jetë në kronor suedez (SEK) dhe t'u referohet kostove të faturueshme në buxhetin e dakordësuar për detyrën dhe të përcaktojë në mënyrë të qartë dallimin midis tarifave, kostove të rimbursueshme për personelin e siguruar dhe kostove të rimbursueshme për personelin dhe kostot e detyrës.

Për sa u përket tarifave për çdo person që ka punuar në Projekt/program do të jepet numri i orëve/ditëve/muajve, niveli i tarifës dhe shuma e faturuar.

§ 10:2. Pagesa e faturave

Partneri bashkëpunues do të miratojë pagesën e faturës në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me Marrëveshjen e Kontributit. SIDA do të paguajë vetëm kur dokumentacioni për një miratim të tillë është marrë nga SIDA - zakonisht brenda 30 ditëve nga data e faturës. Në raste të jashtëzakonshme, SIDA mund të paguajë një faturë pa miratimin e partnerit bashkëpunues. Më pas, SIDA do të informojë partnerin bashkëpunues dhe do të kërkojë nga partneri bashkëpunues që të bëjë ndonjë ndryshim në faturën në vijim. Nëse SIDA konstaton se fatura nuk mund të miratohet, SIDA duhet të njoftojë Autoritetin Suedez për këtë brenda 30 ditëve. Autoriteti Suedez duhet të korrigjojë mangësitë brenda 15 ditëve.

Nëse miratimi i partnerëve bashkëpunues është pranuar dhe pagesa e SIDA-s, megjithatë, është vonuar më shumë se 45 ditë nga data e faturës, Autoriteti Suedez ka të drejtë të kërkojë interes për pagesën e vonuar që korrespondon me interesin në llogarinë e interesit të Autoritetit Suedez, me kusht që vonesa nuk ka ndodhur për shkak të mangësive në faturë ose mungesës së raportimit.

§ 11. Prokurimi

Partneri bashkëpunues duhet të jetë kryesisht pala prokuresë. Autoriteti Suedez në konsultim me SIDA-n, nëse lind një nevojë e tillë, mund të emërojë një konsulent të pavarur prokurimi për të mbështetur partnerin e bashkëpunimit. Kostoja për një mbështetje të tillë do të përfshihet në buxhetin për kontributin e SIDA-s. Nëse Autoriteti Suedez gjykon se partnerit bashkëpunues i mungon kompetenca dhe kapaciteti i duhur për të zbatuar prokurimin, atëherë ai duhet të zbatohet nga Autoriteti Suedez.

Legjislacioni kombëtar i prokurimit do të zbatohet nëse përmbush parimet e njohura ndërkombëtarisht (mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, transparencë, proporcionaliteti dhe njohja reciproke). Nëse Autoriteti Suedez vlerëson se rregullimi i prokurimit të vendit bashkëpunues nuk është i barasvlershëm me parimet e njohura ndërkombëtarisht të prokurimit, duhet të zbatohen udhëzimet e prokurimit të SIDA-s (dhjetor 2004) ose rregullorja e barasvlershme ndërkombëtare (p.sh., e Bankës Botërore, OKB-së ose Komisionit Evropian). Nëse Autoriteti Suedez do të jetë pala prokuresë, do të zbatohet Akti Suedez i Prokurimit Publik (LOU).

Autoriteti Suedez, nëse është e nevojshme, mund të kërkojë një auditim të prokurimit. Kostoja për një auditim të tillë do të mbulohet nga buxheti i kontributit të SIDA-s.

§ 12. Raportimi mbi detyrat individuale

Autoriteti Suedez do të dorëzojë raportimin financiar dhe raportimin narrativ të orientuar te SIDA. Raportet do të miratohen nga partneri bashkëpunues. Nëse nuk është rënë dakord për asgjë tjetër në një detyrë individuale, raportet narrative dhe raportet financiare do të jenë vjetore. Për detyrat më të shkurtra se një vit, raportimi mbi detyrat e përfunduara duhet të dorëzohet jo më vonë se data e rënë dakord në Marrëveshjen midis agjencive për blerjen e shërbimeve.

Raporte narrative

Autoriteti Suedez do të paraqesë çdo vit raporte te SIDA, të cilat përshkruajnë progresin e Projektit/programit.

Raporti duhet të analizojë rezultatet në lidhje me kornizën e rezultateve të dakordësuara të Projektit/programit dhe duhet të analizojë çdo devijim. Raporti duhet të përmbajë, gjithashtu, një vlerësim të përditësuar të riskut dhe një rishikim të masave të zbatuara dhe të planifikuara për trajtimin e riskut.

Kur programi/Projekti të përfundojë, Autoriteti Suedez do të paraqesë një raport përfundimtar te SIDA në lidhje me gjithë periudhën e aktivitetit në datën e specifikuar në Marrëveshjen midis agjencive për blerjen e shërbimeve. Për projektet/programet më të shkurtra se një vit, raporti vjetor përputhet me raportin përfundimtar.

Si Autoriteti Suedez, ashtu edhe partneri bashkëpunues, përveç kërkesave të raportimit të dhëna më sipër, kanë mundësinë të paraqesin komentet me rëndësi për rezultatet e bashkëpunimit.

Raportimi financiar

Raporti financiar duhet të përmbajë një llogari të përdorimit të buxhetit për projekte/programme të ndryshme në përputhje me udhëzimet në shtojcën B. Duhet të justifikohet çdo rishpërndarje brenda zërave të buxhetit për tarifë, kostot e rimbursueshme dhe kostot e detyrës.

Kur Projekti/programi ka përfunduar plotësisht, Autoriteti Suedez do të paraqesë një raport financiar në të cilin do të jepet kostoja totale për të gjithë Projektin/programin, si dhe mënyra se si janë përdorur fondet e kontribuara. Raporti do të paraqesë një analizë të buxhetit të dakordësuar. Çdo kontribut nga Autoriteti, ndarja e kostos me partnerët bashkëpunues dhe kontributet e tjera të donatorëve duhet të specifikohen.

§ 13. Korrupsioni

SIDA, Autoriteti Suedez dhe pala bashkëpunuese do të punojnë së bashku për të parandaluar dhe shkurajuar korrupsionin. Palët do të informojnë menjëherë njëra tjetrën nëse ka dyshime për korrupsion. Do të përcaktohet se cila palë ka përgjegjësinë kryesore për veprimet që duhen ndërmarrë.

§ 14. Sigurimi i një partneri bashkëpunues gjatë udhëtimit si pjesë e një Projekti/ përprojekte

Autoriteti Suedez është përgjegjës për sigurimin e udhëtarëve nga vendi bashkëpunues gjatë udhëtimeve në Suedi ose vende të tjera që zhvillohen si pjesë e Projektit.

§ 15. Të drejtat e pronësisë intelektuale, vizibiliteti/transparenca dhe informacioni

Pala bashkëpunuese dhe SIDA, ose një palë e emëruar nga SIDA në një detyrë individuale, kanë të drejtën e lirë që të përdorin të gjitha materiale dhe të gjitha rezultatet që Autoriteti Suedez ka prodhuar gjatë zbatimit të detyrës, më poshtë “Rezultati”. E drejta e përdorimit është pa kosto dhe përfshin të drejtën për të shpërndarë dhe duplikuar rezultatin, si dhe për ta përdorur atë në kontekste të tjera.

Kur u referohet aktivitetëve, të financuara tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet marrëveshjeve specifike, Autoriteti Suedez gjithmonë duhet të pranojë dhe të bëjë publike se aktivitetet financohen nëpërmjet ndihmës suedeze për zhvillim.

Logoja e Suedisë do të përdoret në prodhimin e materialeve informative dhe në lidhje me aktivitetet informuese. Prodhimi i këtyre materialeve është plotësisht përgjegjësi e Autoritetit Suedez dhe përgjegjësia e përmbajtjes i takon botuesit. SIDA ose “Suedia” nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë që mund të çojë në perceptimin sikur SIDA ose Suedia kanë marrë pjesë në prodhimin ose mbështesin çfarëdo mendimi të paraqitur.

§ 16 . Auditimi

Autoriteti Suedez është përgjegjës për auditimin vjetor të Projektit/programit. Për projektet/ programet që nuk i kalojnë 23 muaj mund të jetë i mjaftueshëm një auditim përfundimtar, në bazë të miratimit të SIDA-s. Për kontributet që nuk tejkalojnë 500 000 SEK, mund të përdoren forma të tjera të kontrollit të kontributit, përveç auditimit. SIDA do të miratojë paraprakisht kontrole të tilla alternative.

Auditimi kryhet nga një auditues i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Do të zbatohet modeli i SIDA-s për termat e referencës për auditimin vjetor, shtojca C. Kostoja e auditimit duhet të përfshihet në buxhetin e Projektit/programit përkatës, shtojca A.

Audituesi duhet të paraqesë komente në raportin e tij sipas ISA 800/805, nëse raporti financiar është në përputhje me kontabilitetin themelor dhe udhëzimet e SIDA-s për raportim në përputhje me pikën § 12. Nëse komisioni është miratuar paraprakisht nga SIDA, mund të përdoret auditimi sipas marrëveshjes specifike 4400.

Raporti i audituesit duhet të përmbajë vëzhgimet që audituesi ka bërë gjatë procesit të shqyrtimit, si dhe informacione nëse Autoriteti Suedez ka marrë masat e përshtatshme bazuar në rekomandimet e mëparshme të auditimit.

Autoriteti Suedez do të dorëzojë raportin e audituesit të SIDA jo më vonë se 10 ditë para shqyrtimit vjetor për Projektin/programin përkatës. Një përgjigje ndaj raportit të audituesit, si dhe një plan veprimi i përcaktuar kohor do të përgatiten nga Autoriteti Suedez dhe do të paraqiten të SIDA jo më vonë se tri javë pas shqyrtimit vjetor për përpjekjet përkatëse.

Kriteri i auditimit më sipër vlen vetëm për zbatimin e projekteve/programmeve dhe jo për blerjen e shërbimeve ose produkteve të kufizuara. Për sa i përket blerjes së shërbimeve ose produkteve të kufizuara, SIDA ka të drejtë të kërkojë realizimin e një auditimi të veçantë.

Nëse Autoriteti Suedez vepron si ndërmjetës i fondeve për zbatimin e një Projekti/programi, Autoriteti Suedez do të jetë përgjegjës për auditimin vjetor të fondeve në përputhje me kërkesat e dhëna më sipër.

Autoriteti Suedez do të bashkëpunojë dhe do të asistojë SIDA-n në çdo shqyrtim shtesë, ndjekje dhe studime financiare që SIDA mund të kërkojë.

§ 17. Sekreti/konfidencialiteti dhe siguria

Autoriteti Suedez do të sigurojë që stafi dhe konsulentët të pranojnë dhe të ndjekin rregullat dhe rregulloret mbi çështjet e fshehtësisë/konfidencialitetit dhe sigurisë që SIDA/autoriteti i huaj vënë në praktikë.

§ 18. Detyrimi për të informuar

Autoriteti Suedez, partnerët bashkëpunues dhe SIDA janë përgjegjës për të informuar njëri-tjetrin sa më shpejt që të jetë e mundur për ndryshime të rëndësishme në qëllimet, përmbajtjen, fushë-veprimin ose kohëzgjatjen e detyrës dhe devijimet e tjera të rëndësishme ose për vështirësi ose probleme gjatë zbatimit të detyrës. Ndryshimet e planifikuara të rëndësishme në detyrë duhet të miratohen paraprakisht nga SIDA.

Kushtet e lartpërmendura duhet të përfshihen në marrëveshjet e lidhura nga SIDA ose Autoriteti Suedez me vendin ose organizatën partnere në vendin partner.

SHTOJCAT:

Shtojca A: Modeli i buxhetit;

Shtojca B: Modeli i raportimit financiar;

Shtojca C: Modeli i deklaratës së misionit, auditimi vjetor.